



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legislacioni.gov.al

Nr. 130

Datë 15 gusht 2014

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 519, datë 6.8.2014	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për aparatin e Kryeministrit..... 5947
Vendim i KM nr. 520, datë 6.8.2014	Për miratimin e rregullore “Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me kancerogjenët dhe mutagjenët në punë”..... 5947
Vendim i KM nr. 521, datë 6.8.2014	Për miratimin e rregullore “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës ¹ ”..... 5952
Vendim i KM nr. 522, datë 6.8.2014	Për miratimin e rregullore “Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me agjentët kimikë në punë”..... 5955
Vendim i KM nr. 523, datë 6.8.2014	Për miratimin e rregullore “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e punëmarrësve lidhur me punën e krahut me ngarkesa ¹ ” dhe për shfuqizimin e pikave 15.1 deri 15.10, të aneksit V, të vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore për sigurinë në kantier”..... 5964
Vendim i KM nr. 524, datë 6.8.2014	Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Punëve të Brendshme, të ambienteve të repartit ushtarak nr. 5010, në Bunavi, Vlorë, për zhvillimin e kurseve bazë të policisë, për vitin 2014..... 5967
Vendim i KM nr. 525, datë 6.8.2014	Për emërimin e dy anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në..... 5967
Vendim i KM nr. 526, datë 6.8.2014	Për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara që trajtohen me përparësi si përfitues të programeve sociale të strehimit..... 5968

Vendim i KM nr. 527, datë 6.8.2014	Për miratimin e procedurave, kriterëve dhe përparësive për përfitimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët.....	5968
Vendim i KM nr. 528, datë 6.8.2014	Për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2015-2017.. ..	5969
Vendim i KM nr. 529, datë 6.8.2014	Për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me ekspertë të Policisë së Shtetit, në misionin paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS).....	5971
Vendim i KM nr. 532, datë 6.8.2014	Për disa shtesa në vendimin nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.....	5971
Vendim i KM nr. 533, datë 6.8.2014	Për një shtesë në vendimin nr. 514, datë 30.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”.....	5972
Vendim i KM nr. 534, datë 6.8.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë. 30.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Kulturës dhe qendrën kombëtare të kinematografisë, për mbulimin e shpenzimeve që do të kryhen në kuadër të organizimit të punëve në vijim të ardhjes së Papa Françeskut në Shqipëri”.....	5972
Vendim i KM nr. 535, datë 6.8.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 414, datë. 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Financave”.....	5972
Vendim i KM nr. 537, datë 6.8.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar.....	5973
Vendim i KM nr. 538, datë 6.8.2014	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës për Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Ministrinë e Kulturës, për mbulimin e shpenzimeve që do të kryhen në kuadër të organizimit të punëve në vijim të ardhjes së Papa Françeskut në Shqipëri.....	5975
Vendim i KM nr. 541, datë 7.8.2014	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për disa institucione, për festimet e 70-Vjetorit të Çlirimit të Vendlindjes.....	5975
Udhëzim i KM nr. 2, datë 6.8.2014	Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2014.....	5976

VENDIM**Nr. 519, datë 6.8.2014****PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR APARATIN E KRYEMINISTRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aparatit të Kryeministrit, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, t’i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”, për funksionimin e grupit Task-Forcë “Për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajtshme shtetërore, në kuptim të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondi i kontingjencës për vitin 2014.

3. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 520, datë 6.8.2014****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MBROJTJEN E SIGURISË DHE SHËNDETIT TË PUNËMARRËSVE NGA RISQET E LIDHURA ME KANCEROGJENËT DHE MUTAGJENËT NË PUNË”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 2, shkronja “b”, 39, pika 1, shkronja “b”, e 44, pika 1, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

1. Direktiva e BE-së 98/24 KE, e datës 7 prill 1998, “Për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëmarrësve nga risqet e lidhura me kancerogjenët dhe mutagenët në punë” (Direktiva e gjashtë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1), të Direktivës së Këshillit 89/391/KEE). Celex 32004L0037.

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me kancerogjenët dhe mutagenët në punë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha ministrat dhe institucionet në varësi të tyre për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE**PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE NGA RISQET E LIDHURA ME KANCEROGJENËT DHE MUTAGJENËT NË PUNË****SEKSIONI I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1**
Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet parandalimit të risqeve që janë të pranishëm ose mund të krijohen nga ekspozimi ndaj kancerogjenëve ose mutagenëve në punë.

2. Lidhur me asbestin si agjent kancerogjen, dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen kur ato janë më të favorshme për sigurinë dhe shëndetin në punë se sa dispozitat e rregullave të zbatueshme për asbestin.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termit e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

a) “Kancerogjen” është:

i) çdo substancë që plotëson kriteret për klasifikimin si kancerogjen i kategorisë 1A ose 1B, sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve kimike;

ii) çdo përzierje e përbërë prej një apo më shumë substancash, të përmendura në pikën a(i), ku përqëndrimi i një apo më shumë substancave individuale plotëson kërkesat për kufijtë e përqëndrimit për klasifikimin e përzierjes si kancerogjene e kategorisë 1A ose 1B, sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve kimike;

b) “Mutagen” është:

i) çdo substancë ose përzierje që përmban një ose më shumë substanca dhe që plotëson kriteret për klasifikimin si mutagen i kategorisë 1A ose 1B, sipas

legjislacionit në fuqi mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve kimike;

ii) çdo përzierje që përmban një ose më shumë substanca, të përmendura në pikën b(i), ku përqëndrimi i një apo më shumë substancave individuale plotëson kërkesat për kufijtë e përqëndrimit për klasifikimin e përzierjes si mutagjene e kategorisë 1A ose 1B, sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve kimike;

c) “Vlerë kufi” është, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe, kufiri i mesatares së ponderuar në kohë i përqëndrimit të një kancerogjeni ose mutagjeni në ajër brenda zonës së frymëmarrjes² së një punëmarrësi në lidhje me një periudhë reference të specifikuar, siç përcaktohet në shtojcën III.

Neni 3

Fusha e zbatimi, përcaktimi dhe vlerësimi i risqeve

1. Kjo rregullore zbatohet për veprimtaritë, në të cilat punëmarrësit janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj kancerogjenëve ose mutagjenëve si rezultat i punës së tyre.

2. Për çdo veprimtari që mund të përfshijë një risk të ekspozimit ndaj kancerogjenëve ose mutagjenëve, përcaktohet natyra, shkalla dhe kohëzgjatja e ekspozimit të punëmarrësve në mënyrë të atillë që të mundësohet vlerësimi i çdo risku për sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve, si dhe të përcaktohen masat që duhen marrë.

3. Rivlerësimi i riskut kryhet rregullisht të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodh një ndryshim në kushtet që mund të ndikojnë në ekspozimin e punëmarrësve ndaj kancerogjenëve ose mutagjenëve.

4. Punëdhënësi duhet t'i japë autoriteteve të inspektimit, me kërkesë të këtyre të fundit, gjithë informacionet e përdorura për të kryer vlerësimin e riskut.

5. Kur vlerësohet risku, merren parasysh të gjitha rrugët e ekspozimit të tilla si përthithja në ose përmes lëkurës.

6. Kur kryhet vlerësimi i riskut, punëdhënësi i kushton vëmendje të veçantë çdo pasoje që ka lidhje me sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve në risk të

veçantë. Punëdhënësi kujdeset që punëmarrësit në risk të veçantë të mos ekspozohen në zonat ku mund të jenë në kontakt me kancerogjenët ose mutagjenët.

SEKSIONI II

DETYRIMET E PUNËDHËNËSIT

Neni 4

Reduktimi dhe zëvendësimi

1. Punëdhënësi redukton përdorimin e kancerogjenit ose mutagjenit në vendin e punës, konkretisht duke e zëvendësuar atë, për aq sa është e mundur teknikisht, me një substancë, përzierje ose proces, i cili në kushtet e përdorimit nuk është i rrezikshëm ose është më pak i rrezikshëm për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve.

2. Punëdhënësi dokumenton masat që merr për reduktimin dhe zëvendësimin dhe i paraqet autoriteteve të inspektimit, me kërkesë të këtyre të fundit, rezultatet e kërkimeve të kryera dhe/ose masat e marra sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 5

Parandalimi dhe reduktimi i ekspozimit

1. Kur rezultatet e vlerësimit të riskut tregojnë një risk për sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve, ekspozimi i punëmarrësve duhet të parandalohet.

2. Kur nuk është e mundur teknikisht që një kancerogjen ose mutagjen të zëvendësohet me një substancë, përzierje ose proces, i cili, në kushtet e tij të përdorimit nuk është i rrezikshëm ose është më pak i rrezikshëm për sigurinë ose shëndetin, punëdhënësi siguron që substanca kancerogjene ose mutagjene të prodhohet dhe përdoret në një sistem të mbyllur, brenda mundësive teknike.

3. Kur një sistem i mbyllur nuk është teknikisht i mundur, punëdhënësi siguron që niveli i ekspozimit të punëmarrësve të reduktohet në një nivel sa më të ulët që është e mundur teknikisht sipas teknologjive më të mira të disponueshme.

4. Ekspozimi nuk tejkalon vlerën kufi të një kancerogjeni të përcaktuar në shtojcën III.

5. Kur përdoret një kancerogjen ose mutagjen, punëdhënësi zbaton të gjitha masat e mëposhtme:

a) kufizimin e sasive të kancerogjenit ose mutagjenit në vendin e punës;

b) mbajtjen e sa më pak punëmarrësve të ekspozuar ose që mund të ekspozohen;

c) projektimin e proceseve të punës dhe masave të kontrollit inxhinierik, në mënyrë që të shmanget ose minimizohet çlirimi i kancerogjenëve ose mutagjenëve në vendin e punës;

ç) largimin e kancerogjenëve ose mutagjenëve në burim, praninë e një sistemi lokal të ekstraktimit ose ajrimit të përgjithshëm, të gjitha metodat e përshtatshme

² Sipas përkufizimit të dhënë në standardin EN 1540 “Ekspozimi në vendin e punës- terminologjia”: “Zonë e frymëmarrjes quhet hapësira rreth hundës dhe gojës nga e cila merret frymë”. Teknikisht zona e frymëmarrjes është hemisfera (përgjithësisht e pranuar me rreze 30 cm) përpara fytyrës me qendër në mes të vijës që bashkon veshët. Baza e hemisferës është një plan që kalon përmes kësaj vije, majës së kokës dhe laringut. Ky përshkrim teknik nuk aplikohet kur përdoret pajisje mbrojtëse respiratore.

dhe në përputhje me nevojën për të mbrojtur shëndetin publik dhe mjedisin;

d) përdorimin e procedurave të përshtatshme ekzistuese për matjen e kancerogjenëve ose mutagjenëve, në veçanti për identifikimin e hershëm të ekspozimeve anormale që rezultojnë nga një ngjarje e paparashikuar ose nga një aksident;

dh) zbatimin e procedurave dhe metodave të përshtatshme të punës;

e) masat mbrojtëse kolektive dhe/ose masat mbrojtëse individuale, kur ekspozimi nuk mund të shmanget me anë të mjeteve të tjera;

ë) masat higjieno-sanitare, në veçanti pastrimin rregullisht të dysHEMEVE, mureve dhe sipërfaqeve të tjera;

f) informimin e punëmarrësve;

g) caktimin e kufijve të zonave me risk dhe përdorimin e shenjave të përshtatshme të paralajmërimit dhe të sigurisë, përfshirë shenjën “Ndalohej duhani”, në zonat ku punëmarrësit janë ekspozuar ose mund të ekspozohen ndaj kancerogjenëve ose mutagjenëve;

gj) hartimin e planeve për përballimin e emergjencave që mund të rezultojnë në ekspozim shumë të lartë;

h) mjete për magazinim, trajtimin dhe transportimin e sigurt, në veçanti duke përdorur kontejnerë të mbyllur dhe të etiketuar qartësisht dhe në mënyrë të dallueshme;

i) mjete për mbledhjen, magazinimin dhe mbajtjen e sigurt të mbetjeve nga punëmarrësit, përfshirë përdorimin e kontejnerëve të mbyllur dhe të etiketuar qartësisht dhe në mënyrë të dallueshme.

Neni 6

Informacion për autoritetin e inspektimit

1. Kur rezultatet e vlerësimit të riskut tregojnë një risk për sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve, punëdhënësi, kur i kërkohet, vë në dispozicion të autoritetit të inspektimit informacione të përshtatshme lidhur me:

a) veprimtaritë dhe/ose proceset industriale të zhvilluara, përfshirë arsyet për të cilat përdoren kancerogjenët ose mutagjenët;

b) sasi të substancave ose përzierjeve të prodhuara ose të përdorura që përmbajnë kancerogjenë ose mutagjenë;

c) numrin e punëmarrësve të ekspozuar;

ç) natyrën dhe shkallën e ekspozimit;

d) llojin e pajisjeve mbrojtëse të përdorura;

dh) masat parandaluese të marra;

e) rastet e zëvendësimeve.

Neni 7

Ekspozimi i paparashikuar

1. Në rast të një ngjarjeje të paparashikuar ose të një aksidenti që mund të rezultojë në një ekspozim të lartë të punëmarrësve, punëdhënësi informon punëmarrësit lidhur me këtë ekspozim.

2. Derisa situata të rikthehet në normalitet dhe shkaqet e ekspozimit të lartë të jenë eliminuar:

a) Lejohen të punojnë në zonën e prekur vetëm ata punëmarrës që janë të domosdoshëm dhe të trajnuar profesionalisht për kryerjen e riparimeve dhe për punë të tjera të nevojshme.

b) Punëmarrësve në fjalë u sigurohen pajisje mbrojtëse individuale, në veçanti veshje mbrojtëse dhe pajisje mbrojtëse të frymëmarrjes, që mbahen për sa kohë zgjat ekspozimi i lartë. Ekspozimi nuk mund të jetë i vazhdueshëm; koha e ekspozimit për çdo punëmarrës mbahet në minimumin strikt të kohës së nevojshme.

c) Punëmarrësit e pambrojtur nuk lejohet të punojnë në zonën e prekur.

Neni 8

Ekspozimi i parashikueshëm

1. Për disa veprimtari të caktuara, si mirëmbajtja, ku është i parashikueshëm ekspozim i lartë, pasi janë shteruar të gjitha masat e nevojshme parandaluese teknike, punëdhënësi përcakton masat e nevojshme për të reduktuar kohëzgjatjen e ekspozimit të punëmarrësve në minimumin e mundshëm. Këto masa merren nga punëdhënësi pas konsultimit me punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre në ndërmarrje ose filialet e saj. Këto masa nuk kufizojnë ose përjashtojnë përgjegjësinë e punëdhënësit, për marrjen e masave të nevojshme për të reduktuar kohëzgjatjen e ekspozimit të punëmarrësve në minimumin e mundshëm dhe për të garantuar mbrojtjen e tyre gjatë kryerjes së proceseve të tilla të punës.

2. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, punëmarrësve në fjalë u sigurohen pajisje mbrojtëse individuale, në veçanti veshje mbrojtëse dhe pajisje mbrojtëse të frymëmarrjes, që mbahen për sa kohë zgjat ekspozimi i lartë. Ky ekspozim nuk mund të jetë i përhershëm dhe duhet të mbahet në minimumin strikt të kohës së nevojshme për secilin punëmarrës.

3. Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për të siguruar që zonat në të cilat zhvillohen veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni të jenë të caktuara me kufij dhe të shënuara në mënyrë të qartë, ose të ndalohej me mënyra të tjera hyrja e personave të paautorizuar në këto zona.

Neni 9

Akresi në zonat e riskut

Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për të siguruar akses vetëm për punëmarrësit, që për shkak të punës dhe funksionit janë të detyruar të hyjnë në zonat ku zhvillohen veprimtaritë, për të cilat rezultatet e vlerësimit të riskut tregojnë një risk për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve.

Neni 10

Masat higjieno-sanitare dhe të mbrojtjes individuale

1. Për të gjitha veprimtaritë ku ka një risk për ndotjen nga kancerogjenët ose mutagjenët, punëdhënësi është i detyruar të marrë masa të përshtatshme për të siguruar që:

a) punëmarrësit të mos konsumojnë ushqime, lëngje dhe duhan në zonat ku ka një risk për ndotje nga kancerogjenët ose mutagjenët;

b) punëmarrësit të pajisen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose me veshje të tjera speciale të përshtatshme;

c) të ketë vende të ndara të mbajtjes për veshjet e punës, veshjet mbrojtëse dhe për veshjet e zakonshme;

ç) punëmarrësve t'u vihen në dispozicion mjete dhe mjedise të përshtatshme dhe të mjaftueshme për shërbimet higjieno-sanitare;

d) pajisjet mbrojtëse të ruhen në mënyrë të përshtatshme në një vend të përcaktuar. Ato kontrollohen dhe pastrohen pas çdo përdorimi dhe, nëse është e mundur edhe përpara përdorimit të tyre;

dh) pajisjet me defekte të riparohen ose zëvendësohen përpara përdorimit të mëtejshëm.

2. Kostot financiare të masave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni nuk u ngarkohen punëmarrësve.

Neni 11

Formimi i punëmarrësve

1. Punëdhënësi merr masat e duhura për të siguruar formimin e mjaftueshëm dhe të përshtatshëm të punëmarrësve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në ndërmarrje ose në filialet e saj, mbi gjithë informacionin e disponueshëm, në veçanti në formën e informacionit dhe udhëzimeve lidhur me:

a) risqet potenciale për shëndetin, përfshirë risqet shitesë për shkak të konsumit të duhanit;

b) masat për të parandaluar ekspozimin;

c) kërkesat higjieno-sanitare;

ç) veshjen dhe përdorimin e veshjeve dhe pajisjeve mbrojtëse;

d) masat për të parandaluar aksidentet, si dhe hapat që duhen marrë nga punëmarrësit, përfshirë edhe personelin e emergjencës, në rastin e aksidenteve dhe për të parandaluar aksidentet.

5950

Formimi përshtatet me ndryshimet e risqeve ekzistuese ose mundësinë e risqeve të reja dhe përsëritet në mënyrë periodike, sa herë është e nevojshme.

2. Punëdhënësit informojnë punëmarrësit mbi instalimet dhe kontejnerët e lidhur me to që përmbajnë kancerogjenë ose mutagjenë, si dhe sigurojnë që këta të jenë të etiketuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme, si dhe të kenë shenja qartësisht të dukshme paralajmëruese dhe të rrezikut.

Neni 12

Informimi i punëmarrësve

1. Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për të siguruar që:

a) punëmarrësit dhe/ose çdo përfaqësues i tyre në ndërmarrje ose filialet e saj informohen sa më parë për mundësinë e ekspozimeve të larta, përfshirë ato të përmendura në nenin 8, për shkaqet e ekspozimit dhe për masat e marra ose që duhen marrë për të përmirësuar situatën;

b) punëdhënësi mban një listë të përditësuar të punëmarrësve të angazhuar në veprimtaritë për të cilat rezultatet e vlerësimit të riskut nxjerrin në pah një risk për sigurinë dhe shëndetin e tyre, si dhe të dhëna mbi agjentët dhe ekspozimin që ata kanë pësuar, nëse informacioni është i disponueshëm;

c) mjeku dhe/ose autoriteti i inspektimit, si dhe persona të tjerë që kanë përgjegjësi për shëndetin dhe sigurinë në punë, kanë akses në listën e përmendur në shkronjën b të pikës 1 të këtij neni;

ç) çdo punëmarrës ka akses vetëm në informacionin që lidhet me të personalisht;

d) punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre në ndërmarrje ose filialet e saj kanë akses në informacionin kolektiv anonim.

Neni 13

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve

1. Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për të siguruar që punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre në ndërmarrje ose filialet e saj të mund të kontrollojnë dhe/ose të mund të përfshihen në zbatimin e kësaj rregulloreje lidhur me:

a) pasojat për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve lidhur me përzgjedhjen, mbajtjen dhe përdorimin e veshjeve dhe pajisjeve mbrojtëse, pa cenuar përgjegjësinë e punëdhënësve për të përcaktuar se sa të efektshme janë veshjet dhe pajisjet mbrojtëse;

b) masat e përcaktuara nga punëdhënësi sipas pikës 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje, pa përjashtuar përgjegjësinë e punëdhënësit për përcaktimin e masave të tilla.

SEKSIONI III DISPOZITA TË PËRZIERA

Neni 14

Mbikëqyrja shëndetësore

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën për sistemin e mbikëqyrjes shëndetësore, punëdhënësi merr masa për kryerjen e mbikëqyrjes shëndetësore të punëmarrësve për të cilët vlerësimi i riskut ka treguar risk për sigurinë dhe shëndetin e tyre.

Kjo mbikëqyrje shëndetësore kryhet në mënyrë të përshtatshme:

- përpara ekspozimit;
- në intervale të rregullta më pas.

Masat e mbikëqyrjes shëndetësore duhet të jenë të një natyre të tillë që të lejojnë zbatimin e drejtpërdrejtë dhe pa pengesa të masave të higjienës personale ose të higjienës në punë.

2. Kur vërehet se një punëmarrës vuan nga një çrregullim shëndetësor, i cili dyshohet të jetë rezultat i ekspozimit ndaj kancerogjenëve ose mutagjenëve, mjeku ose autoriteti i inspektimit përgjegjës për mbikëqyrjen shëndetësore të punëmarrësve mund t'u kërkojë punëmarrësve të tjerë që kanë pasur ekspozim të ngjashëm, t'i nënshtrohen mbikëqyrjes shëndetësore. Në këtë rast, kryhet një rivlerësim i riskut në përputhje me pikën 2 të nenit 3.

3. Në rastet kur kryhet mbikëqyrja shëndetësore, dokumentohen të dhënat shëndetësore individuale dhe mjeku ose autoriteti i inspektimit përgjegjës për mbikëqyrjen shëndetësore të punëmarrësve propozon çdo masë mbrojtëse ose parandaluese që duhet marrë për çdo punëmarrës.

4. Punëdhënësi informon dhe këshillon punëmarrësit mbi mbikëqyrjen shëndetësore, së cilës ata mund t'i nënshtrohen pas përfundimit të ekspozimit.

5. Në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikat kombëtare:

a) punëmarrësit kanë akses në rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore që ka lidhje me ta personalisht; dhe

b) punëmarrësit e prekur ose punëdhënësi mund të kërkojnë një rishikim të rezultateve të mbikëqyrjes shëndetësore.

6. Rekomandime praktike për mbikëqyrjen shëndetësore të punëmarrësve jepen në shtojcën II.

7. Të gjitha rastet e identifikuar me kancer si rezultat i ekspozimit në punë ndaj kancerogjenëve ose mutagjenëve deklarohen pranë autoritetit të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 15

Mbajta e kartelës së shëndetit në punë

1. Lista e përmendur në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 12, dhe të dhënat individuale të shëndetit të përmendura në pikën 3, të nenit 14, të kësaj rregulloreje, mbahen për të paktën 40 vjet pas përfundimit të ekspozimit dhe në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikat kombëtare.

2. Kur ndërmarrja pushon veprimtarinë, dokumentet sipas pikës 1 të këtij neni dorëzohen pranë strukturave rajonale të shëndetit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe/ose praktikat kombëtare.

Neni 16

Vlerat kufi

Vlerat kufi dhe dispozita të tjera të lidhura drejtpërdrejt me to përcaktohen në shtojcën III të kësaj rregulloreje.

Neni 17

Përdorimi i të dhënave

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë ka akses në të dhënat e mbledhura nga autoritetet e inspektimit, sipas pikës 7, të nenit 14, të kësaj rregulloreje. Këto të dhëna mund të përdoren vetëm për kërkim, vendimmarrje dhe qëllime statistikore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e të dhënave personale.

SHTOJCA 1

LISTA E SUBSTANCAVE, PËRZIERJEVE DHE PROCESVE

a) Prodhimi i auraminës.

b) Puna që përfshin ekspozimin ndaj hidrokarbureve policiklike aromatike të pranishëm në blozën e qymyrit, në katranin e qymyrit, ose në ziftin e tij.

c) Puna që përfshin ekspozimin ndaj pluhurave, tymrave dhe spërkatjeve të prodhuara gjatë pjekjes dhe elektrorafinimit të bakër-nikelit të papërpunuar.

d) Proces me acid të fortë në prodhimin e alkoolit izopropilik.

e) Puna që përfshin ekspozimin ndaj pluhurave të drurit të fortë, si p.sh.: lisi ose ahu.³

³ Një listë e disa drurëve të fortë gjendet në volumnin 62 të monografive mbi vlerësimin e risqeve të substancave kancerogjene të njerëzit “Pluhuri i Drurit dhe Formaldehidi”, i publikuar nga Agjencia Ndërkombëtare për Kërkimin mbi Kancerin (IARC), Lion, 1995.

SHTOJCA II

UDHËZIME PRAKTIKE PËR MBIKËQYRJEN SHËNDETËSORE TË PUNËMARRËSVE

1. Mjeku dhe/ose autoriteti i inspektimit përgjegjës për mbikëqyrjen shëndetësore të punëmarrësve të ekspozuar ndaj substancave kancerogjene ose mutagjene duhet të jetë i njohur me kushtet e ekspozimit ose rrethanat e secilit punëmarrës.

2. Mbikëqyrja shëndetësore e punëmarrësve duhet të kryhet në përputhje me parimet dhe praktikën e mjekësisë së punës; kjo duhet të përfshijë të paktën masat e mëposhtme:

- mbajtjen e të dhënave të historisë mjekësore dhe profesionale të një punëmarrësi;

- një intervistë personale;
- kur është e përshtatshme, mbikëqyrjen biologjike, si dhe identifikimin e efekteve të hershme dhe të kthyeshme.

Teste të mëtejshme mund të vendosen për çdo punëmarrës, kur ai është subjekt i mbikëqyrjes shëndetësore, nën dritën e njohurive më të reja të disponueshme për mjekësinë e punës.

SHTOJCA III

VLERA KUFÏ DHE DISPOZITA TË TJERA TË LIDHURA DREJTPËRDREJT ME TO

A. Vlerat kufi për ekspozimin në punë

Emri i agjentit	CAS ⁽¹⁾	Vlerat kufi		Shënim
		mg/m ³ ⁽²⁾	ppm ⁽³⁾	
Benzeni	71-43-2	3,25 ⁽⁴⁾	1 ⁽⁴⁾	Lëkurë ⁽⁵⁾
Monomeri i klorurit të vinilit	75-01-4	7,77 ⁽⁴⁾	3 ⁽⁴⁾	-
Pluhura të drurit të fortë	-	5,0 ^{(4) (6)}	-	-

B. Dispozita të tjera të lidhura drejtpërdrejt me vlerat kufi

⁽¹⁾ CAS: Shërbimi i Abstrakteve Kimike.

⁽²⁾ mg/m³ = miligramë për metër kub ajër në temperaturë 20°C dhe 101,3 kPa. (760 mm trysni Hg).

⁽³⁾ ppm = pjesë për milion sipas vëllimit në ajër (në ml/m³).

⁽⁴⁾ I matur ose i llogaritur në lidhje me një periudhë reference prej tetë orësh.

⁽⁵⁾ Kontribut thelbësor në barrën e përgjithshme të trupit nëpërmjet ekspozimit të mundshëm përmes lëkurës.

⁽⁶⁾ Fraksioni i thithshëm: nëse pluhurat e drurit të fortë përzihen me pluhura të tjerë druri, vlera kufi zbatohet për të gjithë pluhurat e drurit të pranishëm në atë përzierje.

VENDIM

Nr. 521, datë 6.8.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR PUNËN ME PAJISJE ME EKTRAN SHFAQËS”⁴

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 2, shkronja “b”, 39, pika 1, shkronja “b”, e 44, pika 1, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha ministratë dhe institucionet në varësi të tyre për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE

PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR PUNËN ME PAJISJE ME EKTRAN SHFAQËS

SEKSIONI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin për punën me pajisje me ekran shfaqës.

2. Rregullorja zbatohet për të gjitha subjektet dhe vendet e punës, brenda fushës së zbatimit të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, ku zhvillohet një veprimtari pune ose formim, pavarësisht mënyrës së organizimit, llojeve të pronësisë, ose arsytet pse zhvillohet puna ose formimi në vendin e punës.

3. Kjo rregullore nuk zbatohet për:

a) pajisjet me ekran shfaqës në kabinat e shoferëve ose kabinat e kontrollit për automjetet ose makineritë;

⁴ Direktiva e Këshillit 90/270 KE, e datës 29 maj 1990, “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekrane shfaqës” (direktiva e pestë individuale në kuptim të nenit 16 (1) të direktivës 89/391/KEE) (Celex 31990L0270).

b) pajisjet me ekran shfaqës në bordin e mjeteve të transportit;

c) pajisjet me ekran shfaqës të cilat janë kryesisht për përdorim publik;

ç) pajisjet “portative” me ekran shfaqës jo me përdorim të zgjatur në një vend individual pune;

d) makinat llogaritëse, pajisjet numëruese të parave dhe çfarëdo pajisje që ka një ekran shfaqës të vogël të dhënave ose të matjes, të nevojshëm për përdorimin direkt të pajisjes;

dh) makinat e shtypit me projektimin tradicional, të njohura si “makina shtypit me dritare”.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

a) “Pajisje me ekran shfaqës” është çdo ekran shfaqës, që reflekton shkronja, numra, shenja ose figura, pavarësisht procesit të shfaqjes që përdoret;

b) “Vendi individual i punës” është një tërësi elementesh, që përfshin pajisjet me ekran shfaqës, që mund të shoqërohen me tastierë, ose pajisje për hedhjen e informacionit dhe/ose software-in, i cili përcakton ndërfaqen operator-makinë, pajisjet ndihmëse fakultative, pajisjet e jashtme duke përfshirë telefonin, modemin, printerin, mbajtësen e dokumenteve, karrigen dhe tryezën e punës ose sipërfaqen e punës, si dhe mjedisin e punës përreth tij.

c) “Punëmarrës në punë me pajisje me ekran shfaqës” është çdo punëmarrës, siç përkufizohet në ligjin nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i cili përdor rregullisht pajisje me ekran shfaqës, jo më pak se 4 orë në ditë pune.

ç) “Ergonomia” është një disiplinë, e cila fokusohet te parimet e projektimit të elementeve të sistemit të punës, përfshirë objektet, proceset dhe kushtet e punës, që t'i përshtaten njeriut, me qëllim zvogëlimin e sforcimit fizik, parehatisë dhe risqeve.

SEKSIONI II

DETYRIMET E PUNËDHËNËSVE

Neni 3

Analiza e vendeve individuale të punës

1. Punëdhënësi kryen një analizë të vendeve individuale të punës, për të vlerësuar kushtet e sigurisë dhe shëndetit për punëmarrësit, veçanërisht lidhur me risqet e mundshme për shikimin, lodhjen fizike dhe mendore.

2. Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për të korrigjuar kushtet e punës dhe për të zvogëluar ose eliminuar risqet e gjetura, mbi bazën e vlerësimit të

përmendur në pikën 1, duke marrë parasysh efektet shitesë dhe/ose të kombinuara të risqeve të konstatuara.

3. Punëdhënësi ndërmerr hapa të përshtatshme për të siguruar që vendi individual i punës të plotësojë kërkesat e përcaktuara në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Puna e përditshme

Punëdhënësi planifikon veprimtaritë e punëmarrësit në mënyrë të tillë që, puna me ekran shfaqës, të ndërpritet rregullisht, nëpërmjet pushimeve ose ndryshimeve të veprimtarisë, për të zvogëluar ngarkesën e punës me ekran shfaqës.

Neni 5

Informimi dhe formimi i punëmarrësve

1. Punëdhënësi informon punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre për të gjitha aspektet e sigurisë dhe shëndetit mbi vendin e tyre individual të punës, lidhur me pajisjet me ekran shfaqës, veçanërisht për masat e përcaktuara në nenet 3, 5 dhe 7, si dhe për çdo masë të sigurisë dhe shëndetit të marrë në përputhje me këtë rregullore.

2. Punëdhënësi siguron formim të përshtatshëm për sigurinë dhe shëndetin në vendin individual të punës lidhur me pajisjet me ekran shfaqës, përpara fillimit të punës dhe sa herë që organizimi i vendit individual të punës ndryshon në mënyrë thelbësore.

Neni 6

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve

Në përputhje me nenin 13 të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, punëdhënësi merr masa të përshtatshme për konsultimin dhe pjesëmarrjen e punëmarrësve në lidhje me punën me pajisje me ekran shfaqës, rezultatet e analizës së vendeve të punës dhe masat që duhet të merren, për të zvogëluar dhe eliminuar aspektet negative të punës.

Neni 7

Mbikëqyrja shëndetësore

1. Mbrojtja e syve dhe e shikimit të punëmarrësve.

a) Punëdhënësi siguron për punëmarrësit një test të përshtatshëm të syve dhe shikimit nga një specialist i fushës.

- përpara fillimit të punës me ekrane shfaqëse,

- më pas, në intervale të rregullta, minimumi 1 herë në 3 vjet,

- nëse paraqesin vështirësi të shikimit, që mund të jenë për shkak të punës me ekrane shfaqëse.

b) Punëdhënësi siguron ekzaminim oftalmologjik për punëmarrësit kur rezultatet e testit të përmendur në pikën 1.a të këtij neni tregojnë se kjo është e nevojshme.

c) Nëse rezultatet e testit të përmendur në pikën 1.a, ose të ekzaminimit të përmendur në pikën 1.b të këtij neni, tregojnë se është e nevojshme dhe nëse pajisjet korrigjuese për përdorim normal nuk mund të përdoren, punëdhënësi pajis punëmarrësin me pajisje korrigjuese speciale, të përshtatshme për punën në fjalë.

2. Nëse punëmarrësi paraqet ndonjë problem shëndetësor, në lidhje me punën me ekran shfaqës, punëdhënësi siguron një ekzaminim shëndetësor të sistemit muskulo-skeletik, neurologjik dhe të venave.

3. Masat e marra në bazë të këtij neni, në asnjë rrethanë, nuk mund t'i ngarkojnë punëmarrësit me kosto financiare shtesë.

SHTOJCË KËRKESA MINIMALE

Koment paraprak

Detyrimet e përcaktuara në këtë shtojcë zbatohen për të arritur objektivat e kësaj rregulloreje, në mënyrë që:

- elementët e nevojshëm të pajisjeve me ekran shfaqës, të jenë të pranishëm në vendin individual të punës; dhe

- kërkesat bazë ose karakteristikat e punës me pajisje me ekran shfaqës të mos e pengojnë zbatimin e kësaj rregulloreje.

Përshtatjet teknike me kërkesat e kësaj rregulloreje duhet të marrin parasysh progresin teknik.

1. PAJISJET

a) Koment i përgjithshëm

Përdorimi i pajisjes me ekran shfaqës, në vendin individual të punës, nuk paraqet risk për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrëseve.

b) Ekranit shfaqës

Shenjat në ekran janë me konture dhe forma të qarta, me përmasa të përshtatshme dhe me hapësirë të mjaftueshme ndërmjet shenjave dhe vijave.

Imazhi në ekran është i qëndrueshëm, pa dridhje ose forma të tjera të paqëndrueshmërisë.

Ndriçimi dhe/ose kontrasti ndërmjet shenjave dhe sfondit janë lehtësisht të ndryshueshme nga punëmarrësi dhe lehtësisht të përshtatshme me kushtet e ambientit.

Ekranit është lehtësisht i rrotullueshëm dhe i anueshëm për t'iu përshtatur nevojave të punëmarrësit.

Është i mundur përdorimi i një baze të ndarë për ekranin, ose një tavoline, që mund të përshtatet.

Ekranit nuk ka shkëlqim dhe reflektim verbues që mund të shkaktojë parehati për punëmarrësin.

Distanca optimale e të parit, ndërmjet syrit të punëmarrësit dhe detajit të vëzhguar në ekran, varet nga përmasa e detajit dhe ekranit shfaqës dhe është ndërmjet 500-700 mm. Distanca e të parit nuk duhet të jetë më e vogël se 400 mm.

c) Tastiera

Tastiera është e anueshme dhe e ndarë nga ekranit në

mënyrë që punëmarrësi të gjejë pozicion të rehatshëm pune duke shmangur lodhjen e duarve ose krahëve.

Hapësira përballë tastierës është e mjaftueshme për të ofruar mbështetje për duart dhe krahët e punëmarrësit.

Tastiera ka sipërfaqe jo reflektuese për të shmangur shkëlqimin verbues.

Dizenjimi dhe përmasat e butonave të tastierës lehtësojnë përdorimin e saj.

Simbolet në butonat e tastierës janë me kontrast të mjaftueshëm dhe të lexueshme nga pozicioni normal i punës.

ç) Tryeza e punës ose platforma e punës

Tryeza ose syprina e punës kanë sipërfaqe të mjaftueshme, me gjatësi të paktën 1200 mm dhe me gjerësi të paktën 750 mm, me reflektim të ulët dhe lejojnë vendosje të përshtatshme të ekranit, tastierës, dokumenteve dhe pajisjeve të lidhura.

Mbajtësja e dokumenteve është e qëndrueshme dhe e përshtatshme dhe pozicionohet në mënyrë që të minimizojë nevojën për lëvizje të parehatshme të kokës dhe të syve.

Hapësira e punës është e mjaftueshme për punëmarrësin për të gjetur një pozicion pune të rehatshëm dhe për të ndryshuar pozicionin e këmbëve. Hapësira poshtë pjesës ku punohet ka lartësi prej të paktën 650 mm, gjerësi 500-800 mm dhe thellësi prej 750 mm.

d) Karrigia e punës

Karrigia e punës është e qëndrueshme dhe i lejon punëmarrësit lirshmëri lëvizjeje dhe pozicion të rehatshëm.

Ndenjësja ka lartësi të ndryshueshme prej 400 deri 520 mm, thellësi prej 350 deri 500 mm dhe gjerësi rreth 480 mm.

Mbështetësja e ndenjësës është e ndryshueshme në lartësi dhe në pjerrësi.

Është e përshtatshme që ndenjësja të jetë e pajisur me mbështetëse për çlodhjen e krahëve, me lartësi rreth 270 mm mbi ndenjësën, gjerësi minimale prej 70 mm dhe distanca ndërmjet vendeve për çlodhjen e krahëve prej 500 mm.

Mbështetëse për këmbët ofrohet për çdo punëmarrës sipas kërkesës së tij. Mbështetësja për këmbët ka lartësi dhe pjerrësi të ndryshueshme nga 5° deri 15°, gjatësi minimale prej 450 mm, gjerësi minimale prej 300 mm dhe sipërfaqe jo rrëshqitëse.

2. MJEDISI

a) Kërkesa të hapësirës

Hapësira e vendit individual të punës është jo më pak se 12m³ për person dhe projektohet në mënyrë të tillë që të ofrojë lehtësi për ndryshimin e pozicionit dhe kryerjen e lëvizjeve të punëmarrësit.

b) Ndriçimi

Ndriçimi i mjedisit të punës dhe/ose ndriçimi i vendit individual të punës sigurohet në nivele nga 300 deri 700 luks dhe me kontrast të përshtatshëm ndërmjet ekranit dhe mjedisit në sfond, duke marrë parasysh llojin e punës dhe nevojat e shikimit të përdoruesit.

Shkëlqimi i mundshëm verbues shqetësues dhe reflektimet në ekran ose pajisje të tjera parandalohen nëpërmjet përshtatjes së vendit të punës dhe vendit individual të punës me pozicionimin dhe karakteristikat teknike të burimeve artificiale të dritës.

c) Reflektimet dhe shkëlqimi verbues

Vendet individuale të punës projektohen në mënyrë të tillë që burimet e dritës, si dritaret dhe pjesë të tjera të hapura, sipërfaqet ndarëse të tejdukshme ose që lejojnë kalimin e dritës dhe instalimet, ose muret e ngjyrosura me ngjyra të shndritshme, të mos shkaktojnë shkëlqim verbues të drejtpërdrejtë dhe as reflektime shpërqëndruese mbi ekran.

Dritaret pajisen me sistem të përshtatshëm mbulimi të ndryshueshëm për të zbutur dritën e diellit, që bie mbi vendin individual të punës.

ç) Zhurma

Gjatë mobilimit të vendit ose vendeve individuale të punës, merret parasysh që zhurma e emetuar nga pajisjet të mos kalojë vlerën prej 60dB(A) në vendin individual, për të mos shpërqëndruar vëmendjen ose vështirësuar komunikimin.

d) Temperatura

Pajisjet që i përkasin vendit ose vendeve individuale të punës nuk prodhojnë nxehtësi të tepërt, që mund të shkaktojë parehati për punëmarrësit. Temperatura optimale është 22-27° C dhe temperatura e pranueshme 18-30° C.

dh) Rrezatimi

Rrezatimi, me përjashtim të pjesës së dukshme të spektrit elektromagnetik, është në nivele të papërfillshme nga pikëpamja e mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve.

e) Lagështia

Niveli i lagështisë mbahet në nivele të pranueshme, ndërmjet 30-70%.

3. NDËRFAQJA E OPERATORIT/ KOMPJUTERIT

Në projektimin, përzgjedhjen, autorizimin dhe modifikimin e software-it dhe në projektimin e detyrave, që përfshijnë përdorimin e pajisjeve me ekran shfaqës, punëdhënësi merr parasysh parimet e mëposhtme:

a) software-i është i përshtatshëm për detyrën;

b) software-i është i lehtë për t'u përdorur dhe, kur është e përshtatshme, i adaptueshëm me nivelin e njohurive ose përvojën e punëmarrësit; asnjë pajisje kontrolluese sasiore ose cilësore nuk mund të përdoret pa dijeninë e punëmarrësve;

c) sistemet i japin informacion punëmarrësit mbi ecurinë e punës së tyre;

ç) sistemet paraqesin informacion në një format dhe në një ritëm të përshtatshëm për punëmarrësit;

d) parimet e ergonomisë së software-it zbatohen, në veçanti, për përpunimin e të dhënave njerëzore.

dh) pajisjet e kontrollit sasior dhe cilësor nuk mund të përdoren pa informimin paraprak të punëmarrësit.

VENDIM

Nr. 522, datë 6.8.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MBROJTJEN E SIGURISË DHE SHËNDETIT TË PUNËMARRËSVE NGA RISQET E LIDHURA ME AGJENTËT KIMIKË NË PUNË”⁵

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 2, shkronja “b”, 39, pika 1, shkronja “b”, e 44, pika 1, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me agjentët kimikë në punë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha ministratë dhe institucionet në varësi të tyre për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

RREGULLORE

PËR MBROJTJEN E SIGURISË DHE SHËNDETIT TË PUNËMARRËSVE NGA RISQET LIDHUR ME AGJENTËT KIMIKË NË PUNË

SEKSIONI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave minimale për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet që shkaktohen apo mund të shkaktohen nga efektet e agjentëve kimikë të pranishëm në vendin e punës, ose si rezultat i çdo veprimtarie të punës që përfshin agjentë kimikë.

⁵ Direktiva e BE-së 98/24 KE, e datës 7 prill 1998, “Për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëmarrësve nga risqet e lidhura me agjentët kimikë në punë”, (direktiva e katërbëdhjetë individuale në kuptim të nenit 16(1) të direktivës 89/391/KEE) (Celex 31998L0024).

2. Rregullorja zbatohet në rastet kur agentët kimikë të rrezikshëm janë të pranishëm ose mund të jenë të pranishëm në vendin e punës, pa kufizuar në asnjë rast zbatimin e dispozitave ligjore mbi agentët kimikë të përcaktuara në legjislacionin mbi mbrojtjen nga rrezatimi dhe në legjislacionin mbi mbrojtjen nga kancerogjenët dhe mutagjenët në vendin e punës.

3. Kjo rregullore zbatohet pa kufizuar zbatimin e legjislacionit më shtrëngues dhe/ose më specifik që rregullon transportin e mallrave të rrezikshme, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë në këtë fushë.

Neni 2 Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

a) “Agjent kimik” është çdo element ose përbërje kimike, vetëm ose në formë të përzier, siç ndodhet në gjendjen natyrale ose siç prodhohet, përdoret ose çlirohet, përshirë çlirimin si mbetje, nëpërmjet çfarëdo veprimtarie pune, prodhuar me qëllim ose jo dhe hedhur në treg ose jo;

b) “Agjent kimik i rrezikshëm” është:

i) çdo agjent kimik që plotëson kriteret për klasifikim si substancë ose perzierje e rrezikshme sipas legjislacionit në fuqi për substancat dhe perzierjet kimike, përveç atyre që plotësojnë vetëm kriteret për klasifikim si të rrezikshëm për mjedisin,

ii) çdo agjent kimik i cili, pavarësisht se nuk plotëson kriteret për klasifikim si i rrezikshëm në përputhje me pikën b(i) të këtij neni, mundet që për shkak të vetive të tij fiziko-kimike, kimike ose toksikologjike, si dhe mënyrës se si përdoret ose është i pranishëm në vendin e punës, të paraqesë risk për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, duke përfshirë çdo agjent kimik për të cilin është caktuar një vlerë kufi e ekspozimit në punë;

c) “Veprimtari që përfshin agjentë kimikë”, është çdo punë në të cilën përdoren ose synohet të përdoren agjentët kimikë, në çfarëdo lloji procesi, duke përfshirë prodhimin, përpunimin, ruajtjen, transportin, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe trajtimin e tyre, ose që rezulton nga një punë e tillë;

ç) “Vlerë kufi e ekspozimit në punë” është, nëse nuk është specifikuar ndryshe, kufiri i mesatares së ponderuar në kohë të përqendrimit të një agjenti kimik në ajër brenda zonës së frymëmarrjes⁶ së punëmarrësit

⁶ Zona e frymëmarrjes, sipas përkufizimit të dhënë në standardin EN 1540 “është hemisfera me rreze 30 cm përpara fytyrës, me qendër në mes të vijës që bashkon veshët. Baza e hemisferës është një plan që kalon përmes kësaj vije, majës së kokës dhe laringut. Ky përshkrim 5956

në lidhje me një periudhë kohore reference specifike;

d) “Vlerë kufi biologjike” është kufiri i përqendrimit në mjedisin biologjik të përshtatshëm të agjentit përkatës, metabolitit të tij ose të një indikatorit të efektit;

dh) “Mbikëqyrje shëndetësore” është vlerësimi i gjendjes shëndetësore të një punëmarrësi në lidhje me ekspozimin ndaj agjentëve kimikë specifikë në punë;

e) “Rrezik” është vetia e qenësishme e një agjenti kimik me potencial për të shkaktuar dëm;

ë) “Risk” është probabiliteti që dëmi potencial të shfaqet në kushtet e përdorimit dhe/ose ekspozimit.

Neni 3 Vlerat kufi të ekspozimit në punë dhe vlerat kufi biologjike

1. Vlerat kufi të ekspozimit në punë janë përcaktuar në shtojcën 1 dhe vlerat kufi biologjike përcaktohen në shtojcën 2. Këto vlera kufi janë të detyrueshme brenda fushës së zbatimit të kësaj rregulloreje.

2. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë monitoron dhe propozon pranë Këshillit të Ministrave ndryshimin e vlerave kufi të ekspozimit në punë dhe vlerave kufi biologjike dhe informon për këto vlera organizatat e punëmarrësve dhe të punëdhënësve.

SEKSIONI II DETYRIMET E PUNËDHËNËSIT

Neni 4 Përcaktimi dhe vlerësimi i riskut të agjentëve kimikë të rrezikshëm

1. Punëdhënësi përcakton nëse agjentë kimikë të rrezikshëm janë të pranishëm në vendin e punës. Ai vlerëson risqet për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve që lindin nga këta agjentë kimikë, duke marrë parasysh elementët e mëposhtëm:

a) vetitë e rrezikshme;

b) informacionin mbi sigurinë dhe shëndetin të ofruar nga furnizuesi, përfshirë tabelat e të dhënave të sigurisë (SDS);

c) nivelin, llojin dhe kohëzgjatjen e ekspozimit;

ç) rrethanat e punës që përfshijnë agjentë të tillë, përfshirë sasinë e tyre;

d) vlerat kombëtare kufi të ekspozimit në punë ose vlerat kufi biologjike;

dh) efektin e masave parandaluese të marra ose që duhen marrë;

e) kur është e mundur, përfundimet që nxirren nga mbikëqyrja shëndetësore e kryer.

Punëdhënësi siguron informacione shtesë që

teknik nuk aplikohet kur përdoret pajisje mbrojtëse respiratore.

nevojiten për vlerësimin e riskut nga furnizuesi ose nga burime të tjera lehtësisht të disponueshme. Kur është e përshtatshme, ky informacion përfshin vlerësimin specifik lidhur me riskun për përdoruesit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për agentët kimikë.

2. Punëdhënësi zotëron dokumentin e vlerësimit të riskut, dhe identifikon masat parandaluese dhe mbrojtëse që janë marrë në përputhje me nenet 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje. Dokumenti i vlerësimit të riskut mbahet i përditësuar, veçanërisht nëse ka pasur ndryshime të rëndësishme në rrethanat e vendit të punës ose nëse mbikëqyrja shëndetësore e punëmarrësve tregon se kjo është e nevojshme. Vlerësimi i riskut dokumentohet në një formë të përshtatshme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mund të përfshijë një justifikim nga ana e punëdhënësit se natyra e risqeve të lidhura me agjentët kimikë, e bëjnë të panevojshëm një vlerësim të mëtejshëm të detajuar.

3. Vlerësimi i riskut përfshin edhe disa aktivitete të caktuara të ndërmarrjes ose veprimtarisë së saj, të tilla si mirëmbajtja, për të cilat parashikohet se ka një risk për ekspozim të rëndësishëm, ose që mund të ketë efekte të dëmshme për sigurinë dhe shëndetin për arsye të tjera edhe pasi janë marrë të gjitha masat teknike.

4. Në rastin e aktiviteteve që përfshijnë ekspozimin ndaj disa agjentëve kimikë të rrezikshëm, risku vlerësohet mbi bazën e riskut që paraqitet nga të gjithë këta agjentë kimikë të kombinuar.

5. Një aktivitet i ri që përfshin agjentë kimikë të rrezikshëm fillon vetëm pasi të jetë kryer vlerësimi i risqeve të kësaj veprimtarie dhe pasi të jenë zbatuar masat parandaluese të identifikuara.

Neni 5

Parime të përgjithshme për parandalimin e risqeve

1. Për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve në çdo aktivitet që përfshin praninë e agjentëve kimikë të rrezikshëm, punëdhënësi merr masat e nevojshme parandaluese, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, përfshirë ato të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Risqet për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve në çfarëdo veprimtarie që përfshin agjentë kimikë të rrezikshëm eliminohen ose reduktohen në minimum nëpërmjet:

a) projektimit dhe organizimit të punës në vendin e punës;

b) ofrimit të pajisjeve të përshtatshme për punë me agjentë kimikë dhe parashikimi i procedurave të mirëmbajtjes, të cilat sigurojnë shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësve në punë;

c) reduktimit në minimum të numrit të punëmarrësve të ekspozuar, ose që mund të ekspozohen;

ç) reduktimit në minimum të kohëzgjatjes dhe intensitetit të ekspozimit;

d) masave higjieno-sanitare të përshtatshme;

dh) reduktimit të sasisë së agjentëve kimikë të pranishëm në vendin e punës në minimumin e kërkuar për llojin e punës në fjalë;

e) procedurave të përshtatshme të punës, përfshirë masat për trajtimin, ruajtjen dhe transportin e sigurt brenda vendit të punës të agjentëve kimikë të rrezikshëm dhe mbetjeve që përmbajnë agjentë kimikë të tillë.

3. Kur rezultatet e vlerësimit të riskut nxjerrin në pah një risk për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, zbatohen masat specifike të mbrojtjes, parandalimit dhe monitorimit të përcaktuara në nenet 6, 7 dhe 10 të kësaj rregulloreje.

4. Kur rezultatet e vlerësimit të riskut tregojnë se, për shkak të sasive të një agjenti kimik të rrezikshëm të pranishëm në vendin e punës, ka vetëm një risk të ulët për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve dhe masat e marra në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni janë të mjaftueshme për të zvogëluar atë risk, atëherë dispozitat e neneve 6, 7 dhe 10 të kësaj rregulloreje nuk zbatohen.

Neni 6

Masa specifike të mbrojtjes dhe të parandalimit

1. Punëdhënësi garanton që risku për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve në punë nga një agjent kimik i rrezikshëm të eliminohet ose zvogëlohet në minimum.

2. Zëvendësimi kryhet me përparësi dhe është procesi nëpërmjet të cilit punëdhënësi shmang përdorimin e një agjenti kimik të rrezikshëm, duke e zëvendësuar atë me një agjent kimik ose proces, që në kushtet e përdorimit të tij nuk është i rrezikshëm, ose është më pak i rrezikshëm për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, sipas rastit. Kur natyra e veçantë e aktivitetit nuk lejon që risku të eliminohet nëpërmjet zëvendësimit, atëherë punëdhënësi siguron që risku të reduktohet në minimum nëpërmjet zbatimit të masave të mbrojtjes dhe të parandalimit, në përputhje me vlerësimin e riskut, sipas këtij rendi prioritar:

a) Projektimi i proceseve të përshtatshme të punës dhe kontrolleve teknike, si dhe përdorimi i pajisjeve dhe materialeve të përshtatshme për të shmangur apo minimizuar çlirimin e agjentëve kimikë të rrezikshëm;

b) Zbatimi i masave të mbrojtjes kolektive në burimin e riskut, si ajrimi i përshtatshëm, ose masa të tjera teknike dhe organizative;

c) Zbatimi i masave të mbrojtjes individuale, përfshirë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale, kur ekspozimi nuk mund të parandalohet me mënyra të tjera. Kjo situatë nuk do të jetë e përhershme.

3. Masat e përmendura në pikën 2 të këtij neni shoqërohen, kur është e përshtatshme për natyrën e riskut, nga mbikëqyrja shëndetësore, siç përcaktohet në nenin 10 të kësaj rregulloreje.

4. Punëdhënësi kryen rregullisht matje të agjentëve kimikë të rrezikshëm, si dhe kur ka ndryshime në kushtet, të cilat mund të ndikojnë në ekspozimin e punëmarrësve ndaj agjentëve kimikë, në vendin e punës, sipas nevojës, në veçanti në lidhje me vlerat kufi të ekspozimit në punë, përveç rasteve kur ai provon përmes formave të tjera të përshtatshme të vlerësimit se është arritur parandalimi dhe mbrojtja e duhur sipas pikës 2 të këtij neni.

5. Në çdo rast, punëdhënësi vepron menjëherë për të përmirësuar situatën duke zbatuar masa parandaluese dhe mbrojtëse, nëse vlera kufi e ekspozimit në punë dhe/ose vlera kufi biologjike është tejkaluar, duke marrë parasysh natyrën e atij kufiri.

6. Punëdhënësi, mbi bazën e vlerësimit të riskut dhe parimeve të përgjithshme për parandalimin e risqeve, merr masa teknike dhe/ose organizative, të përshtatshme me natyrën e aktivitetit, përfshirë ruajtjen, trajtimin dhe veçimin e agjentëve kimikë të papajtuësishëm, për të siguruar mbrojtjen e punëmarrësve kundrejt rreziqeve që lindin nga vetitë fiziko-kimike të agjentëve kimikë. Punëdhënësi merr masat e përshtatshme sipas këtij rendi përparësie:

a) Për të parandaluar praninë në vendin e punës të përqendrimeve të rrezikshme të substancave që marrin flakë ose sasive të rrezikshme të substancave kimikisht jo të qëndrueshme, ose ku natyra e punës nuk e lejon këtë;

b) Për të shmangur praninë e burimeve të ndezjes, të cilat mund të provokojnë zjarre dhe shpërthime, ose të kushteve të pafavorshme, të cilat mund të bëhen shkak që substancat ose përzierjet e substancave kimikisht të paqëndrueshme të sjellin pasoja fizike të dëmshme; dhe

c) Për të zbutur efektet e dëmshme për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve në rast zjarri ose shpërthimi si pasojë e ndezjes së substancave që marrin flakë ose pasojave fizike të dëmshme që lindin nga substanca kimikisht të paqëndrueshme ose përzierja e substancave.

7. Pajisjet e punës dhe sistemet mbrojtëse të siguruar nga punëdhënësi për mbrojtjen e punëmarrësve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi projektimin, prodhimin dhe furnizimin lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë. Masa teknike dhe/ose organizative të marra nga punëdhënësi marrin në konsideratë dhe janë në përputhje me kategorizimin në grupe të pajisjeve sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi lidhur me pajisjet dhe sistemet e mbrojtjes të synuara për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes.

8. Punëdhënësi siguron kontroll të mjaftueshëm të impianteve, pajisjeve dhe makinerive, si dhe ofrimin e pajisjeve për kufizimin e shpërthimeve ose masave për çlirimin e presionit të shpërthimit.

Neni 7

Masat për menaxhimin e aksidenteve, incidenteve dhe emergjencave

1. Punëdhënësi harton procedura si plane veprimi, dhe merr masa për mbrojtjen e punëmarrësve nga aksidentet, incidentet ose emergjencat që kanë lidhje me agjentë kimikë të rrezikshëm. Këto masa përfshijnë ushtrime përkatëse të sigurisë në intervale kohore të rregullta dhe ofrimin e pajisjeve dhe mjediseve të përshtatshme të ndihmës së parë.

2. Në rastin e një aksidenti ose incidenti, punëdhënësi vepron menjëherë për të eliminuar ose izoluar shkakun, për të zbutur efektet e tij dhe për të informuar punëmarrësit që kanë lidhje me këtë situatë. Për të rivendosur situatën në normalitet:

a) Punëdhënësi zbaton masa të përshtatshme për të përmirësuar situatën sa më shpejt të jetë e mundur;

b) Në zonën e prekur lejohen të punojnë për kryerjen e riparimeve dhe punëve të tjera të nevojshme vetëm ata punëmarrës që janë të domosdoshëm dhe të formuar;

c) Këta punëmarrës pajisen me veshje mbrojtëse, pajisje mbrojtëse individuale dhe pajisje dhe sisteme të posaçme të sigurisë, të cilat përdoren për sa kohë zgjat situata. Kjo situatë nuk do të jetë e përhershme.

ç) Personat e pambrojtur nuk lejohet që të qëndrojnë në zonën e prekur.

3. Punëdhënësi përgatit informacion për masat e emergjencës që përfshin agjentë kimikë të rrezikshëm dhe e vë atë në dispozicion të shërbimeve të brendshme dhe të jashtme të emergjencës. Ky informacion duhet të përfshijë:

a) Njoftimin paraprak mbi rreziqet përkatëse në punë, masat për identifikimin e rreziqeve, masat parandaluese dhe procedurat, në mënyrë që shërbimet e emergjencës të mund të përgatisin masat parandaluese dhe procedurat e veta të kundërpërgjigjes,

b) Çdo informacion të disponueshëm lidhur me rreziqe specifike që krijohen ose mund të krijohen në kohën e një aksidenti ose incidenti, përfshirë informacionin sa u takon procedurave të hartuara në përputhje me këtë nen.

4. Punëdhënësi merr masat e nevojshme për të siguruar praninë e mjeteve paralajmëruese dhe sistemeve të tjera të komunikimit, të nevojshme për të sinjalizuar një risk të shtuar të sigurisë dhe shëndetit dhe për të mundësuar një reagim të përshtatshëm, marrjen e hapave të menjëhershëm të korrigjimit, ndihmës, si dhe mundësimin e largimit dhe shpëtimit menjëherë nëse lind nevoja.

Neni 8

Informimi dhe formimi

1. Punëdhënësi siguron që punëmarrësve dhe/ose përfaqësuesve të tyre t'u ofrohen:

a) Të dhëna të siguruara nga vlerësimi i riskut dhe informacione të tjera, sa herë që një ndryshim madhor në vendin e punës sjell një ndryshim të këtyre të dhënave;

b) Të dhëna për agjentët kimikë të rrezikshëm që ndodhen në vendin e punës, si: emërtimi i tyre, rreziqet për sigurinë dhe shëndetin, vlerat përkatëse kufi të ekspozimit në punë dhe dispozita të tjera ligjore;

c) Formim dhe informim mbi masat parandaluese të përshtatshme dhe veprime për t'u ndërmarrë në mënyrë që të ruajnë veten e tyre dhe punëmarrësit e tjerë në vendin e punës;

ç) Akses në çdo tabelë të të dhënave të sigurisë (SDS) të ofruar nga furnizuesi, sipas legjislacionit në fuqi.

Informacioni ofrohet në një mënyrë që i përshtatet rezultatit të vlerësimit të riskut dhe mbahet i përditësuar, duke përfshirë njoftimin me gojë, udhëzime për punëmarrës të veçantë, formimin e punëmarrësve dhe informacionin me shkrim në varësi të natyrës dhe shkallës së riskut.

2. Në rastet kur kontejnerët dhe tubacionet me agjentë kimikë të rrezikshëm të përdorur në punë nuk shënjohehen në përputhje me legjislacionin për etiketimin e agjentëve kimikë dhe shenjat e sigurisë në vendin e punës, punëdhënësi siguron që përmbajtja dhe natyra e përmbajtjes së kontejnerëve dhe tubacioneve dhe rreziqet që lidhen me substanca kimike të rrezikshme të pranishme të jenë qartësisht të identifikueshme.

SEKSIONI III DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 9 Ndalime

1. Për të parandaluar risqet për shëndetin nga ekspozimi i punëmarrësve ndaj agjentëve kimikë dhe/ose nga veprimtari të caktuara që përfshijnë agjentë kimikë, prodhimi, fabrikimi ose përdorimi në punë i agjentëve kimikë dhe veprimtarive të përcaktuara në shtojcën 3 ndalohet në masën e përcaktuar në këtë shtojcë.

2. Ministri përgjegjës për shëndetësinë lejon përjashtime nga kërkesat e pikës 1 të këtij neni, rast pas rasti, vetëm në rrethanat e mëposhtme:

a) për efekt të kërkimit dhe testimit shkencor, përfshirë analizën;

b) për veprimtaritë e synuara për eliminimin e agjentëve kimikë që janë të pranishëm në formën e nën-produkteve ose produkteve mbetje;

c) për prodhimin e agjentëve kimikë të përmendur në pikën 1 të këtij neni për t'u përdorur si produkte të ndërmjetme dhe për përdorimin e tyre si produkte të tillë.

3. Në të gjitha rrethanat e pikës 2 të këtij neni, ekspozimi i punëmarrësve ndaj agjentëve kimikë të përmendur në pikën 1 të këtij neni duhet të shmanget, veçanërisht duke parashikuar që prodhimi dhe përdorimi i agjentëve të tillë kimikë si ndërmjetës të kryhet sa më herët që të jetë e mundur vetëm në një sistem të mbyllur, i cili mundëson që agjenti kimik i lartpërmendur të merret në sasinë e nevojshme për të monitoruar procesin ose për të bërë mirëmbajtje të sistemit.

4. Për lejimin e përjashtimeve sipas pikës 2 të këtij neni, ministri përgjegjës për shëndetësinë i kërkon punëdhënësit që të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) arsyen për kërkimin e përjashtimeve;

b) sasinë e agjentit kimik për t'u përdorur në vit;

c) veprimtaritë dhe/ose proceset ose reaksionet e përfshira;

ç) numrin e punëmarrësve përgjegjës që mund të përfshihen;

d) masat paraprake të parashikuara për të mbrojtur sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve lidhur me këtë proces;

dh) masat teknike dhe organizative që duhet të merren për të parandaluar ekspozimin e punëmarrësve.

Pas depozitimit të të gjithë dokumentacionit përkatës dhe pas shqyrtimit të bërë nga specialistët përkatës, ministri përgjegjës për shëndetësinë vendos miratimin ose jo të kërkesës së punëdhënësit për lejimin e përjashtimeve.

Neni 10

Mbikëqyrja shëndetësore

1. Punëdhënësi organizon mbikëqyrjen shëndetësore të përshtatshme për punëmarrësit për të cilët rezultatet e vlerësimit sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje tregojnë se ka një risk për shëndetin e punëmarrësve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën për sistemin e mbikëqyrjes shëndetësore. Bazuar në rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore, aplikohen masat parandaluese në vendin specifik të punës.

2. Mbikëqyrja shëndetësore, kryhet kur:

a) Ekspozimi i punëmarrësit ndaj një agjenti kimik të rrezikshëm është i tillë që një sëmundje e identifikueshme ose efekt negativ në shëndet mund të jetë i lidhur me ekspozimin; dhe

b) Sëmundja ose pasoja mund të ndodhë në rrethana të veçanta të punës së punëmarrësit; dhe

c) Teknika e shqyrtimit (e përdorur gjatë mbikëqyrjes shëndetësore) paraqet risk minimal për punëmarrësit.

Për më tepër, duhet të ketë teknika të vlefshme për diagnostikimin e sëmundjes ose të pasojave në shëndet.

3. Kur një vlerë kufi biologjike e detyrueshme është mbikëqyrja shëndetësore është një kërkesë e detyrueshme për punën me agjentin kimik të rrezikshëm në fjalë. Punëmarrësit informohen për këtë kërkesë përpara se t'u caktohet detyra që përfshin riskun e ekspozimit ndaj agjentit kimik të rrezikshëm të treguar.

4. Për secilin punëmarrës që i nënshtrohet mbikëqyrjes shëndetësore, mbahen dhe përditësohen të dhënat individuale të shëndetit dhe treguesit e ekspozimit në kartelën individuale të shëndetit në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë. Të dhënat individuale të treguesve biologjikë mund të jenë pjesë e mbikëqyrjes shëndetësore. Punëmarrësi me kërkesën e tij ka akses për të dhënat në kartelën e tij/saj të shëndetit në punë dhe shkallën e ekspozimit. Kopje të kartelës së shëndetit në punë i dorëzohen autoritetit kompetent me kërkesë të tij.

5. Detajet për mbajtjen, ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave shëndetësore, të dhënave të ekspozimit dhe rezultateve të monitorimit biologjik janë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë, të miratuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë. Të dhënat për shëndetin dhe ekspozimin ruhen në mënyrë të përshtatshme që të jetë i mundur konsultimi në një datë të mëvonshme, bazuar në parimin e konfidencialitetit. Kur ndërmarrja pushon veprimtarinë, lista e punëmarrësve të ekspozuar dhe kartelat e shëndetit në punë dorëzohen pranë strukturave rajonale të shëndetit publik, në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikën kombëtare në fuqi.

6. Kur, si rezultat i mbikëqyrjes shëndetësore të kryer nga një mjek ose një profesionist i kujdesit shëndetësor në punë, një punëmarrës konstatohet me një sëmundje të identifikueshme ose efekt negativ për shëndetin si pasojë e ekspozimit në punë ndaj një agjenti kimik të rrezikshëm, ose kur konstatohet tejkalimi i një vlere kufi biologjike të detyrueshme, punëmarrësi informohet nga mjeku ose persona të tjerë të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme për rezultatin që lidhet me atë personalisht përfshirë informacionin dhe këshillimin lidhur me çdo mbikëqyrje shëndetësore që ai duhet t'i nënshtrohet pas përfundimit të ekspozimit, dhe

përcaktuar sipas shtojcës 2 të kësaj rregulloreje, punëdhënësi:

a) rishikon vlerësimin e riskut;

b) rishikon masat e parashikuara për të eliminuar ose reduktuar riskun;

c) merr parasysh këshillën e profesionistit të kujdesit shëndetësor në punë për zbatimin e masave të kërkuara për eliminimin ose reduktimin e riskut, përfshirë mundësinë e caktimit të punëmarrësit në një punë alternative, ku nuk ka risk për ekspozim të mëtejshëm;

ç) siguron mbikëqyrje të vazhdueshme shëndetësore dhe merr masa për rishikimin e gjendjes shëndetësore të punëmarrësve të tjerë që kanë qenë të ekspozuar në mënyrë të ngjashme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë. Në raste të tilla mjeku i punës apo profesionisti i kujdesit shëndetësor në punë propozon që personat e ekspozuar t'i nënshtrohen një ekzaminimi mjekësor.

Neni 11

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre zhvillohet në përputhje me ligjin nr. 10237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë".

Neni 12

Udhëzuesit praktikë

1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe bazuar në udhëzues ndërkombëtarë, ministri përgjegjës për shëndetësinë miraton udhëzues praktikë jo të detyrueshëm, për një periudhë kohe 1-(një) vjeçare nga koha e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje:

a) Udhëzues praktik për përcaktimin dhe vlerësimin e riskut, si dhe për rishikimin dhe rregullimet e nevojshme;

b) Udhëzues praktik për masat parandaluese të përgjithshme për të kontrolluar riskun;

c) Udhëzues praktik për masat specifike mbrojtëse dhe parandaluese për të kontrolluar riskun;

ç) Udhëzues për monitorimin biologjik dhe mbikëqyrjen shëndetësore.

SHTOJCA I
VLERAT KUFË TË EKSPOZIMIT NDAJ AGJENTËVE KIMIKË NË PUNË ⁽¹⁾

“Vlerat kufi të ekspozimit në punë” janë vlera të detyrueshme, të bazuara në shëndet, të cilat përcaktojnë nivelet kufi të ekspozimit, poshtë të cilave, si rregull, nuk pritet të ketë pasoja negative lidhur me çdo substancë të dhënë, pas një ekspozimi ditor ose afat-shkurtër, gjatë gjithë viteve të punës.

Nr.	CAS ⁽²⁾	EMRI I AGJENTIT	VLERAT KUFË TË EKSPozIMIT				Shënim ⁽³⁾
			8 orë ⁽⁴⁾		Afatshkurtër ⁽⁵⁾		
			mg/m ³ ⁽⁵⁾	ppm ⁽⁶⁾	mg/m ³	ppm ⁽⁷⁾	
1	625-16-1	Acetat terc-amili	270	50	540	100	-
2	112-07-2	Acetat butoksi-2-etili	133	20	333	50	lëkurë
3	111-15-9	Acetat etoksi-2-etili	11	2	-	-	lëkurë
4	123-92-2	Acetat izopentili	270	50	540	100	-
5	626-38-0	Acetat metil-1-butili	270	50	540	100	-
6	110-49-6	Acetat metioksi-2-etili	-	1	-	-	lëkurë
7	108-65-6	Acetat metoksi -2-metil-1-etili	275	50	550	100	lëkurë
8	628-63-7	Acetat pentili	270	50	540	100	-
9	620-11-1	Acetat pentili-3	270	50	540	100	-
10	108-05-4	Acetat vinili	17,6	5	35,2	10	-
11	67-64-1	Aceton	1210	500	-	-	-
12	75-05-8	Acetonitril	70	40	-	-	lëkurë
13	64-19-7	Acid acetik	25	10	-	-	-
14	64-18-6	Acid formik	9	5	-	-	-
15	7697-37-2	Acid nitrik	-	-	2,6	1	-
16	7664-38-2	Acid ortofosforik	1	-	2	-	-
17	88-89-1	Acid pikrik	0,1	-	-	-	-
18	79-09-4	Acid propionik	31	10	62	20	-
19	144-62-7	Acidi oksalik	1	-	-	-	-
20	7664-93-9	Acidi sulfurik (mjegull)	0,05	-	-	-	(10, 11)
21	107-18-6	Alkol alilik	4,8	2	12,1	5	lëkurë
22	141-43-5	Amino-2-etanol	2,5	1	7,6	3	lëkurë
23	7664-41-7	Amoniak, anhidër	14	20	36	50	-
24	7440-22-4	Argjend, metalik	0,1	-	-	-	-
25		Argjend, përbërje të tretshme, si Ag	0,01	-	-	-	-
26	26628-22-8	Azid natriumi	0,1	-	0,3	-	lëkurë
27		Barium (përbërje të tretshme, si Ba)	0,5	-	-	-	-
28	7783-07-5	Bihidrogjen selenuri	0,07	0,02	0,17	0,05	-
29	80-05-7	Bisfenol A (pluhur i thithshëm)	10	-	-	-	-
30	75-15-0	Bisulfur karboni	15	5	-	-	lëkurë
31	7726-95-6	Brom	0,7	0,1	-	-	-
32	10035-10-6	Bromur hidrogjeni	-	-	6,7	2	-
33	78-93-3	Butanon	600	200	900	300	-
34	111-76-2	Butoksi-2-etanol	98	20	246	50	lëkurë
35	112-34-5	(Butoksi-2-etoksi)-2- etanol	67,5	10	101,2	15	-
36	420-04-2	Cianamid	1	0,58	-	-	lëkurë
37	110-82-7	Cikloheksan	700	200	-	-	-
38	108-94-1	Cikloheksanon	40,8	10	81,6	20	lëkurë
39	109-89-7	Dietilaminë	15	5	30	10	-
40	75-34-3	Diklor-1,1-etan	412	100	-	-	lëkurë
14	95-50-1	Diklor-1,2-benzen	122	20	306	50	lëkurë
42	106-46-7	Diklor-1,4-benzen	122	20	306	50	-
43	124-40-3	Dimetilaminë	3,8	2	9,4	5	-
44	123-91-1	Dioksan-1,4	73	20	-	-	-
45	124-38-9	Dioksid karboni	9000	5000	-	-	-
46	105-60-2	Epsilon-Kaprolaktam (pluhur dhe avull)	10	-	40	-	-
47	60-29-7	Eter dietilik	308	100	616	200	-
48	115-10-6	Eter dimetilik	1920	1000	-	-	-
49	1634-04-4	Eter metil-terc butilik	183,5	50	367	100	-

Nr.	CAS ⁽²⁾	EMRI I AGJENTIT	VLERAT KUFI TË EKSPOZIMIT				Shënim ⁽³⁾
			8 orë ⁽⁴⁾		Afatshkurtër ⁽⁵⁾		
			mg/m ³ ⁽⁵⁾	ppm ⁽⁶⁾	mg/m ³	ppm ⁽⁷⁾	
50	140-88-5	Etilakrilat	21	5	42	10	-
51	75-04-7	Etilaminë	9,4	5	-	-	-
52	100-41-4	Etilbenzen	442	100	884	200	lëkurë
53	107-21-1	Etilenglikol	52	20	104	40	lëkurë
54	110-80-5	Etoksi-2- etanol	8	2	-	-	lëkurë
55	98-83-9	Fenil-2-propen	246	50	492	100	-
56	108-95-2	Fenol	8	2	16	4	lëkurë
57	7782-41-4	Fluor	1,58	1	3,16	2	-
58	7664-39-3	Fluorur hidrogjeni	1,5	1,8	2,5	3	-
59		Fluorure, inorganike	2,5	-	-	-	-
60	7803-51-2	Fosfinë	0,14	0,1	0,28	0,2	-
61	75-44-5	Fosgjen	0,08	0,02	0,4	0,1	-
62	110-43-0	Heptanon-2	238	50	475	100	lëkurë
63	106-35-4	Heptanon-3	95	20	-	-	-
64	1305-62-0	Hidroksid kalciumi	5	-	-	-	-
65	7580-67-8	Hidrir litiumi	0,025	-	-	-	-
66	78-78-4	Izopentan	3000	1000	-	-	-
67		Kallaj (përbërjet inorganike, si Sn)	2	-	-	-	-
68	7782-50-5	Klor	-	-	1,5	0,5	-
69	75-45-6	Kloridfluormetan	3600	1000	-	-	-
70	75-00-3	Kloretan	268	100	-	-	-
71	67-66-3	Kloroform	10	2	-	-	lëkurë
72	7647-01-0	Klorur hidrogjeni	8	5	15	10	-
73	1319-77-3	Krezol (gjithë izomerët)	22	5	-	-	-
74		Krom (II) inorganik dhe Krom (III) Përbërje inorganike (të patretshme)	2	-	-	-	-
75	7440-47-3	Krom, Metal	2	-	-	-	-
76	1330-20-7	Ksilen, izomere të përziera, i pastër	221	50	442	100	lëkurë
77	98-82-2	Kumen	100	20	250	50	lëkurë
78	108-38-3	m- Ksilen	221	50	442	100	lëkurë
79	108-67-8	Mesitilen (Trimetilbenzenët)	100	20	-	-	(10)
80	67-56-1	Metanol	260	200	-	-	Lëkurë
81	80-62-6	Metil metakrilat	-	50	-	100	-
82	108-10-1	Metil-4-pentanon-2	83	20	208	50	-
83	110-12-3	Metil-5-hekzanon-2	95	20	-	-	-
84	541-85-5	Metil-5-heptanon-3	53	10	107	20	-
85	96-33-3	Metilakrilat	18	5	36	10	-
86	624-83-9	Metilizocianat	-	-	0,02	-	-
87	107-98-2	Metoksi-1-propanol -2	375	100	568	150	Lëkura
88	109-86-4	Metoksi-2-etanol	-	1	-	-	Lëkurë
89	111-77-3	(Metoksi-2-etoksi)- 2- etanol	50,1	10	-	-	Lëkurë
90	34590-94-8	(Metoksi-2-metiletoksi)-propanol	308	50	-	-	Lëkurë
91							Error! Reference source not found.
92		Mërkuri dhe komponimet dyvalente inorganike përfshirë oksidin e mërkurit dhe klorurin e mërkurit (matur si mërkur)	0,02	-	-	-	(9)Error! Reference source not found.
93	108-90-7	Monoklorbenzen	23	5	70	15	-
94	108-90-7	Monoklorbenzen	23	5	70	15	-
95	10102-43-9	Monoksidi azoti	30	25	-	-	-
96	110-91-8	Morfolinë	36	10	72	20	-
97	127-19-5	N,N-Dimetilacetamid	36	10	72	20	Lëkurë
98	68-12-2	N,N-Dimetilformamid	15	5	30	10	Lëkurë

Nr.	CAS ⁽²⁾	EMRI I AGJENTIT	VLERAT KUFË TË EKSPOZIMIT				Shënim ⁽³⁾
			8 orë ⁽⁴⁾		Afatshkurtër ⁽⁵⁾		
			mg/m ³ ⁽⁵⁾	ppm ⁽⁶⁾	mg/m ³	ppm ⁽⁷⁾	
99	91-20-3	Naftalen	50	10	-	-	-
100	141-32-2	n-Butilakrilat	11	2	53	10	-
101	463-82-1	Neopentan	3000	1000	-	-	-
102	110-54-3	n-Hekzan	72	20	-	-	-
103	142-82-5	n-Heptan	2085	500	-	-	-
104	54-11-5	Nikotinë	0,5	-	-	-	Lëkurë
105	98-95-3	Nitrobenzeni	1	0,2	-	-	Lëkurë
106	872-50-4	n-Metil pirolidon-2	40	10	80	20	Lëkurë
107	95-47-6	o-Ksilen	221	50	442	100	Lëkurë
108	10026-13-8	Pentaklorur fosfori	1	-	-	-	-
109	109-66-0	Pentan	3000	1000	-	-	-
110	1314-80-3	Pentasulfur difosfori	1	-	-	-	-
111	1314-56-3	Pentoksid difosfori	1	-	-	-	-
112	110-85-0	Piperazina	0,1	-	0,3	-	-
113	8003-34-7	Piretrum (i pastruar nga laktonet sensitizuese)	1	-	-	-	-
114	110-86-1	Piridinë	15	5	-	-	-
115	106-42-3	p-Ksilen	221	50	442	100	Lëkurë
116	7440-06-4	Platin, metalik	1	-	-	-	-
117		Plumb inorganik dhe përbërje të tij	0,15	-		(8)	
118	108-46-3	Resorcinë	45	10	-	-	Lëkurë
119	3689-24-5	Sulfotep	0,1	-	-	-	Lëkurë
120	7783-06-04	Sulfur hidrogjeni	7	5	14	10	-
121	109-99-9	Tetrahidrofuran	150	50	300	100	Lëkurë
122	108-88-3	Toluen	192	50	384	100	Lëkurë
123	121-44-8	Trietilaminë	8,4	2	12,6	3	Lëkurë
124	71-55-6	Triklor-1,1,1- etan	555	100	1100	200	-
125	120-82-1	Triklor-1,2,4- benzen	15,1	2	37,8	5	Lëkurë
126	526-73-8	Trimetil-1,2,3-benzen	100	20	-	-	-
127	95-63-6	Trimetil-1,2,4-benzen	100	20	-	-	-

¹ Kjo listë përfshin vlerat kufi indikative të ekspozimit në punë të ndodhura në direktivat e Bashkimit Evropian 91/322/KEE, 2000/39/KE, 2006/15/KE dhe 2009/161/KE.

² CAS, Numri i Regjistrimit të Shërbimit të Abstrakteve Kimike.

³ Fjala “Lëkurë” të kolona “Shënim” për një “Vlerë kufi të ekspozimit” tregon mundësinë e një marrjeje të rëndësishme nëpërmjet lëkurës.

⁴ Matur ose llogaritur në lidhje me një mesatare të ponderuar në kohë për një periudhë referimi prej 8 orësh.

⁵ Vlerë kufi e ekspozimit afatshkurtër. Një vlerë kufi mbi të cilën nuk duhet të ndodhë ekspozimi dhe është e lidhur me një periudhë prej 5 minutash, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe.

⁶ mg/mg³: miligram për metër kub ajër në 20°C dhe 101,3 KPa.

⁷ ppm: pjesë për milion sipas volumit në ajër (ml/m³).

⁸ Kjo vlerë kufi për plumbin është e detyrueshme në vendet e Bashkimit Evropian, sipas direktivës 98/24/ KE.

⁹ Gjatë monitorimit të ekspozimit ndaj merkurit dhe përbërjeve të tij inorganike dyvalente, duhet të merren parasysh teknikat përkatëse të monitorimit biologjik që plotësojnë Vlerat Kufi Indikative të Ekspozimit në Punë.

¹⁰ Gjatë përzgjedhjes së një metode të përshtatshme për monitorimin e ekspozimit, merren parasysh kufizimet potenciale dhe interferencat që mund të shfaqen në praninë e përbërjeve të tjera të squfurit.

¹¹ Mjegulla përcaktohet si fraksion toraksi (fraksion i grimcave të inhaluara, që janë në gjendje të kalojnë përtej laringut).

SHTOJCA II

VLERA KUFİ BIOLOGJİKE TË DETYRUESHME DHE MASAT E MBİKËQYRJES SHËNDETËSORE

1. Monitorimi biologjik përfshin matjen e nivelit të plumbit në gjak (PbGj) duke përdorur spektrometrinë e absorbimit atomik ose një metodë që jep rezultate të njëvlershme. Vlera kufi biologjike e detyrueshme është:

70 µg Pb/100 ml gjak.

2. Mbikëqyrja shëndetësore kryhet nëse:

a) ekspozimi ndaj përqendrimit të plumbit në ajër është më i madh se 0,075 mg/metër kub, e llogaritur si një mesatare e ponderuar në kohë për 40 orë në javë; ose

b) niveli i plumbit në gjak te punëmarrësi është më i lartë se 40 µg Pb/100 ml gjak.

3. Udhëzime praktike për monitorimin biologjik dhe mbikëqyrjen shëndetësore përgatiten në përputhje me nenin 12 të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA III

NDALIME

Prodhimi, fabrikimi ose përdorimi në punë i agjentëve kimikë dhe veprimtarive që përfshijnë agjentët kimikë të përcaktuar më poshtë janë të ndaluara. Ndalimi nuk zbatohet nëse agjenti kimik është i pranishëm në një agjent tjetër kimik, ose si pjesë përbërëse e mbetjeve, me kusht që përqendrimi i tij të jetë më i ulët se kufiri i specifikuar.

Agjentët kimikë:

Nr. CAS 91-59-8	β-Naftilamina dhe kripërat e saj (mbi 0,1% m/m);
Nr. CAS 92-67-1	Amino-4-bifenili dhe kripërat e tij (mbi 0,1% m/m);
Nr. CAS 92-87-5	Benzidina dhe kripërat e saj (mbi 0,1% m/m);
Nr. CAS 92-93-3	Nitro-4-bifenili (mbi 0,1%).

VENDIM

Nr. 523, datë 6.8.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE LIDHUR ME PUNËN E KRAHUT ME NGARKESA”⁷ DHE PËR SHFUQIZIMIN E PIKAVE 15.1 DERI 15.10, TË ANEKSIT V, TË VENDIMIT NR. 312, DATË 5.5.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SIGURINË NË KANTIER”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 2, shkronja “b”, 39, pika 1, shkronja “b”, e 44, pika 1, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e punëmarrësve lidhur me punën e krahut me ngarkesa”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pikat nga 15.1 deri te 15.10, të aneksit V, të vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore për sigurinë në kantier”, që kanë të bëjnë me objektin e kësaj rregulloreje, si dhe të gjitha aktet nënligjore që bien ndesh me të, shfuqizohen.

3. Ngarkohen të gjitha ministratë dhe institucionet në varësi të tyre për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE

PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE LIDHUR ME PUNËN E KRAHUT ME NGARKESA

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave minimale për mbrojtjen e sigurisë dhe

⁷ Direktiva e BE-së 90/269/KEE, e datës 29 maj 1990, “Për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë për mbajtjen manuale të ngarkesave kur ka një risk, veçanërisht të dëmtimeve të shpinës për punonjësit” (direktiva e katërt individuale, në kuptim të nenit 16 (1), të direktivës 89/391/KEE) Nr. CELEX: 31990L0269.

shëndetit të punëmarrësve, lidhur me punën e krahut me ngarkesa, kur ka risk për shëndetin, veçanërisht për dëmtime muskulo-skeletore.

2. Rregullorja zbatohet për të gjitha subjektet dhe vendet e punës, brenda fushës së zbatimit të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, ku zhvillohet një veprimtari pune ose formim për punën e krahut.

Neni 2 Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

a) “Punë krahut me ngarkesa” është çdo mënyrë e transportimit, ose mbajtjes së një ngarkese, nga një ose më shumë punëmarrës, përfshirë ngritjen, uljen, shtyrjen, tërheqjen, mbështetjen ose lëvizjen e një ngarkese, e cila për shkak të karakteristikave të saj, ose të kushteve ergonomike të pafavorshme, përfshin një risk, veçanërisht për çrregullime muskulo-skeletore, për punëmarrësit;

b) “Ergonomia” është një disiplinë, e cila fokusohet te parimet e projektimit të elementeve të sistemit të punës, përfshirë objektet, proceset dhe kushtet e punës, që t'i përshtaten njeriut, me qëllim zvogëlimin e sforcimit fizik, parehatisë dhe risqeve.

Neni 3 Detyrimet e punëdhënësit

1. Punëdhënësi merr masat e duhura organizative, ose përdor mjetet e përshtatshme, në veçanti pajisjet mekanike, për të shmangur nevojën për punën e krahut me ngarkesa, nga ana e punëmarrësve.

2. Në rastet kur nevoja për punën e krahut me ngarkesa nuk mund të shmanget, sipas pikës 1 të këtij neni, punëdhënësi merr masat e duhura organizative, përdor pajisjet e përshtatshme ose u vë në dispozicion punëmarrësve pajisjet e nevojshme, sipas shtojcës I të kësaj rregulloreje, për të zvogëluar riskun nga puna e krahut me ngarkesa.

3. Në çdo rast kur puna e krahut me ngarkesa nuk mund të shmanget, punëdhënësi e organizon punën dhe vendet e punës, në mënyrë të tillë që, puna e krahut me ngarkesa të jetë sa më e sigurt dhe e shëndetshme. Për këtë, punëdhënësi ndër të tjera:

a) Vlerëson, paraprakisht nëse është e mundur, kushtet e sigurisë dhe shëndetit për llojin e punës dhe, në veçanti, shqyrton karakteristikat e ngarkesave, sipas shtojcës I; nëse vlerësimi tregon një risk domethënës për dëmtime muskulo-skeletore të shpinës, atëherë, personi përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, kryen një vlerësim më specifik, duke pasur parasysh vlerat udhëzuese të shtojcës II.

b) Merr masat e duhura për të shmangur, ose

zvogëluar, riskun për punëmarrësit, veçanërisht për dëmtime muskulo-skeletore, duke pasur parasysh karakteristikat e mjedisit dhe veprimtarisë së punës, sipas shtojcës I.

4. Në bazë të germës “c”, të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, në çdo rast kur punëdhënësi i cakton punëmarrësit punë krahut me ngarkesa, ai duhet të ketë parasysh faktorët individualë të riskut, përfshirë aftësitë fizike të punëmarrësit, siç përcaktohet në shtojcën II të kësaj rregulloreje dhe rezultatet e ekzaminimeve mjekësore, të kryera sipas legjislacionit në fuqi.

5. Në rastet kur është e nevojshme të vlerësohen aftësitë shëndetësore të punëmarrësit, sipas pikës 4 të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar të sigurojë mbikëqyrje shëndetësore.

Neni 4 Informimi dhe formimi i punëmarrësve

1. Punëdhënësi informon punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre mbi të gjitha masat që zbatohen për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit lidhur me punën e krahut me ngarkesa.

Punëdhënësi siguron që, punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre, të marrin informacione të përgjithshme dhe, kur është e mundur, informacione të hollësishme lidhur me:

a) Peshën dhe karakteristika të tjera të ngarkesës, të tilla si qendra e gravitetit, e anës më të rëndë, kur një ngarkesë ngarkohet në mënyrë të pabalancuar;

b) Riskun e veçantë për dëmtime muskulo-skeletore.

2. Punëdhënësi u siguron punëmarrësve udhëzime dhe formim të duhur, për mënyrën korrekte të punës së krahut me ngarkesa dhe risqet ndaj të cilave ata mund të ekspozohen, veçanërisht nëse puna e krahut me ngarkesa nuk kryhet në mënyrë korrekte, sipas shtojcave I dhe II të kësaj rregulloreje.

Në këto formime duhet të ushtrohen teknikat e duhura për ngritjen lart, mbajtjen dhe shtyrjen/tërheqjen. Është e përshtatshme që të përfshihen ekspertë të tillë si fizioterapistë dhe/ose ergoterapistë.

Neni 5 Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre zhvillohet në përputhje me ligjin nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Neni 6 Mbikëqyrja shëndetësore

1. Punëdhënësi organizon mbikëqyrjen shëndetësore të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin në fuqi

dhe praktikën për sistemin e mbikëqyrjes shëndetësore, në rastet kur:

a) Vlerësimi i riskut tregon një risk për shëndetin dhe sigurinë e tyre si pasojë e punës së krahut me ngarkesa,

b) Është e nevojshme të sigurohet, që aftësitë fizike dhe kapacitetet shëndetësore të punëmarrësit janë të përshtatshme për detyrën e ngarkuar, bazuar në nenin 6(2),

c) Një punëmarrës vuan nga një çrregullim shëndetësor, që dyshohet të jetë rezultat i ngarkesës së punës së krahut me ngarkesa.

2. Rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore merren në konsideratë kur zbatohen masat parandaluese në vendin specifik të punës.

3. Në përputhje me legjislacionin dhe praktikat kombëtare për sistemin e mbikëqyrjes shëndetësore:

a) Punëmarrësit kanë akses në rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore, që ka lidhje me ta dhe

b) Punëmarrësit që preken, ose punëdhënësi, mund të kërkojnë rishikimin e rezultateve të mbikëqyrjes shëndetësore.

4. Të dhënat e mbikëqyrjes shëndetësore, përfshirë përfundimet për aftësinë për punë, për secilin punëmarrës, dokumentohen dhe përditësohen nga mjeku i punës, në përputhje me legjislacionin për mbikëqyrjen shëndetësore dhe për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat për shëndetin e punëmarrësve ruhen në mënyrë të përshtatshme, që të jetë i mundur konsultimi në një datë të mëvonshme, bazuar në parimin e konfidencialitetit. Punëmarrësi, me kërkesë të tij/saj, ka akses te të dhënat e kartelës së tij të shëndetit në punë. Kopje të kartelave të shëndetit në punë u vihen në dispozicion autoriteteve kompetente, me kërkesë të tyre.

SHTOJCA I

FAKTORË REFERENCE PËR PUNËN E KRAHUT ME NGARKESA

1. Karakteristikat e ngarkesës

Puna e krahut me ngarkesa mund të paraqesë risk për shëndetin, veçanërisht për dëmtime muskulo-skeletore nëse ngarkesa është:

- tepër e rëndë, ose tepër e madhe;
- voluminoze, ose e vështirë për t'u kapur;
- e paqëndrueshme, ose me përmbytje që mund të zhvendoset;

- e pozicionuar në një mënyrë që bën të detyrueshme mbajtjen ose manipulimin në një distancë të madhe nga trangu (më shumë se 0.25 m), ose me një përkulje ose përdredhje të trungut; dhe

- me risk shtesë për shkak të kontureve dhe/ose dendësisë së saj, veçanërisht në rastin e një përplasjeje.

2. Aktiviteti fizik i nevojshëm

Një aktivitet fizik mund të paraqesë risk, veçanërisht

për dëmtime të sistemit muskulo-skeletor, në rastet kur:

- është i tepruar;

- arrihet vetëm me anë të një lëvizjeje përdredhëse të trungut;

- mund të rezultojë në një lëvizje të menjëhershme të ngarkesës;

- realizohet duke e mbajtur trupin në një pozicion të paqëndrueshëm.

3. Karakteristikat e mjedisit të punës

Karakteristikat e mjedisit të punës mund të rrisin riskun, veçanërisht për dëmtime të shpinës, nëse:

- nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të zhvilluar veprimtarinë me ngarkesa, në veçanti në drejtim vertikal;

- dyshemeja është e pasheshuar (jo e njëtrajtshme), duke paraqitur rreziqe për pengime, ose është e rrëshqitshme, për llojin e veshjes së këmbëve të punëmarrësit,

- vendi i punës, ose mjedisi i punës, nuk lejon mbajtjen e ngarkesave në një lartësi të sigurt, ose mbajtjen e trupit të punëmarrësit në një pozicion të përshtatshëm;

- ka ndryshime në nivelin e dyshemesë ose sipërfaqes së vendit të punës, të cilat kërkojnë manipulimin e ngarkesave në nivele të ndryshme;

- dyshemeja ose vendi ku qëndron këmba janë të paqëndrueshme;

- temperatura, lagështia ose ajrimi janë të papërshtatshme.

4. Kërkesat e veprimtarisë

Veprimtaria mund të përbëjë risk, veçanërisht për dëmtimin e sistemit muskulo-skeletor, nëse ajo përfshin një ose më shumë nga kërkesat e mëposhtme:

- aktivitete fizike të tejzgjatura, më të shpeshta seç duhet, ose që detyrojnë një qëndrim statik të shtyllës kurrizore;

- një periudhë çlodhjeje e pamjaftueshme;

- distanca të tepruara të ngritjes, uljes ose mbajtjes;

- një ritëm pune, të përcaktuar nga procesi i punës, i cili nuk mund të ndryshohet nga punëmarrësi.

SHTOJCA II

FAKTORËT INDIVIDUALË TË RISKUT

Punëmarrësi mund të jetë në risk nëse ai:

- është i papërshtatshëm për të kryer detyrën në fjalë nga pikëpamja fizike, si obeziteti apo mbipesha, ose nga pikëpamja shëndetësore, si probleme me zemrën dhe me qarkullimin e gjakut;

- mban veshje, këpucë ose aksesore të tjerë personale të papërshtatshëm;

- nuk ka njohuri, ose formim të mjaftueshëm apo të përshtatshëm.

Gjatë kryerjes së vlerësimit për situatat e punës së krahut me ngarkesa, kur ka risk veçanërisht për

dëmtime të sistemit muskulo-skeletor të punëmarrësve, merren parasysh njëkohësisht faktorët e ndryshëm të renditur në shtojcat I dhe II.

SHTOJCA III VLERAT KUFË PËR PUNËN E KRAHUT ME NGARKESA

Vlerat kufi të ngarkesës (pesha maksimale) dhe vlerat kufi të ngarkesës kumulative për ngritjen dhe lëvizjen e ngarkesave, me dy duar, në ditë pune, ose turn, për burra dhe gra, në pozicion bazë, në këmbë dhe në kushte pune optimale janë:

Moshë	Vlerat kufi të ngarkesës ⁸ (kg)		Vlerat kufi kumulative të ngarkesës ⁹ (kg)	
	Mashkull	Femër	Mashkull	Femër
18 – 29 vjeç	45 kg	15 kg	7.500	6.500
30 – 39 vjeç	45 kg	15 kg	7.500	6.500
40 – 49 vjeç	40 kg	15 kg	6.500	6.500
50 – 65 vjeç	35 kg	10 kg	5.500	5.000

Përfshirja e punëmarrësve femra dhe e punëmarrësve të rinj në punën me ngarkesa të jetë i kufizuar dhe në çdo rast pesha maksimale e ngarkesës të jetë shumë më pak sesa ajo që lejohet për burrat.

Gratë shtazën nuk duhet të caktohen në punë me ngarkesa gjatë shtatzënisë dhe dhjetë javë pas lindjes, nëse mjeku specialist është i mendimit se kjo punë mund të rrezikojë shëndetin e nënës dhe të fëmijës.

Kur kushtet e punës nuk janë optimale, pesha e ngarkesës duhet të reduktohet në mënyrë të përshtatshme. Kushtet jo optimale konsiderohen të tilla si vështirësi të kapjes, dysheme të pasheshuar, pozicione pune fiziologjikisht të pafavorshme, mbajtja e ngarkesës me riskun për t'u rrëzuar, mungesa e formës fizike të punëmarrësve etj.

Ngarkesat që peshojnë 30-45 kg, mund të ngrihen nga burrat, në mënyrë të vazhdueshme për maksimumi një orë. Pushimet ndërmjet seksioneve të kohës për ngritjen e ngarkesave nuk duhet të jenë më të shkurtra se 30 minuta.

Për punëmarrësit me aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit në fuqi, përpara se t'u ngarkohet punë krahu me ngarkesa, nevojitet rekomandimi nga mjeku i punës.

⁸ Vlera kufi e ngarkesës është pesha e çdo ngarkese të vetme e cila nuk duhet të tejkalohet në çfarëdo lloj rrethane.

⁹ Vlera kufi kumulative e ngarkesës përbën peshën shumatore, rezultat i peshave të mbajtura dhe numrit të rrugëve në ditë ose turn, e cila nuk duhet të tejkalohet në çfarëdo lloj rrethane.

VENDIM Nr. 524, datë 6.8.2014

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TË AMBIENTEVE TË REPARTIT USHTARAK NR. 5010, NË BUNAVI, VLORË, PËR ZHVILLIMIN E KURSEVE BAZË TË POLICISË, PËR VITIN 2014

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 6-mujore, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Punëve të Brendshme, të katit të parë e të dytë të objektit nr. 3 dhe të tre poligonëve që ndodhen në repartin ushtarak nr. 5010, në Bunavi, Vlorë, për zhvillimin e kurseve bazë të policisë, për vitin 2014.

2. Ministrisë së Punëve të Brendshme i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e ambienteve të repartit ushtarak të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'u japë në përdorim të tretëve.

3. Me përfundimin e kurseve bazë të policisë përpara afatit të përcaktuar në këtë vendim, reparti ushtarak nr. 5010, në Bunavi, Vlorë, t'i kthehet Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme të lidhin një marrëveshje të përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM Nr. 525, datë 6.8.2014

PËR EMËRIMIN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMBËTAR TË PËRZGJEDHJES PËR TND-në

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin si anëtarë të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në, të:

- Z. Agron Dhima;
- Znj. Irena Beqiraj.

2. Në zbatim të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", dhe të pikës 3, të kreut XI, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", mandati i këtyre anëtarëve fillon në mbledhjen e parë konstituive të KKP-së dhe kohëzgjatja e tij përcaktohet në bazë të shortit që do të organizohet për këtë qëllim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 526, datë 6.8.2014

**PËR KATEGORITË E PERSONAVE ME AFTËSI
TË KUFIZUARA QË TRAJTOHEN ME
PËRPARËSI SI PËRFITUES TË PROGRAMEVE
SOCIALE TË STREHIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nënndarjes "i", të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë përparësi për t'u trajtuar si përfitues të programeve sociale të strehimit kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, në kuptim të ligjeve nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, dhe nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 5, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, të grupuar si më poshtë vijon:

a) Të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët, sipas kriterëve mjekësorë, janë të paaftë për punë në kushte normale;

b) Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe mosha;

5968

c) Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë, me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë;

ç) Personat të cilët janë deklaruar invalidë pune, me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas statusit të invalidit të punës.

2. Kategorive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, u jepet prioritet duke i pikëzuar në formatin tip të sistemit të pikëzimit, i cili miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore për çdo program strehimi dhe që shërben për klasifikimin e kërkesave për strehim nga organet e qeverisjes vendore.

3. Ngarkohen organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 527, datë 6.8.2014

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE,
KRITEREVE DHE PËRPARËSIVE PËR
PËRFITIMIN E GRANTIT TË MENJËHERSHËM
PËR BANESAT ME KOSTO TË ULËT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 25/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurave, kriterëve dhe përparësive që zbatohen nga njësitë e qeverisjes vendore dhe organet qendrore për akordimin dhe përfitimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët.

2. Njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 30 janar të çdo viti, paraqesin kërkesat për grante të menjëhershme për banesat me kosto të ulët, pranë ministrisë që mbulon çështjet e strehimit, të shoqëruar me kostot financiare për çdo familje.

3. Ministria, brenda muajit mars, planifikon në buxhetin e shtetit fondet për vitin pasardhës për grantet e menjëhershme, bazuar në kërkesat vjetore të bashkive, sa herë që zbatohen programe të banesave me kosto të ulët.

4. Njësitë e qeverisjes vendore gjatë hartimit të listave të përfituesve, u japin përparësi kategorive të përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi, duke pikëzuar këto kategori në formatin tip të sistemit të pikëzimit, i cili miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes

vendore, për programin e banesave me kosto të ulët, dhe që shërben për klasifikimin e kërkesave për strehim nga organet e qeverisjes vendore.

5. Kriteret dhe përparësitë për përfitimin e grantin të menjëhershëm janë këto:

a) Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara, si më poshtë vijon:

i) persona me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët, sipas kriterëve mjekësorë, janë të paafte për punë në kushte normale dhe që kanë nevojë për kujdestarë;

ii) paraplegjikë dhe tetraplegjikë të cilët, me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, deklarohen se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe mosha e që kanë nevojë për kujdestarë;

iii) persona me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë nevojë për përkujdesje;

b) Individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç.

6. Familjet që plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi, përfitojnë grantin e menjëhershëm, përkatësisht, në masën:

a) 5 për qind të vlerës së banesës me kosto të ulët, familjet e përmendura në shkronjën “a” të pikës 5, me të ardhura maksimale mujore nga 100-120 për qind të të ardhurave mesatare të përcaktuara për prefekturën;

b) 10 për qind të vlerës së banesës me kosto të ulët, familjet e përmendura në shkronjën “a” të pikës 5, me të ardhura maksimale mujore nga 0-99 për qind të të ardhurave mesatare të përcaktuara për prefekturën;

c) 10 për qind të vlerës së banesës me kosto të ulët, individët me statusin e jetimit, të përmendur në shkronjën “b”, të pikës 5.

7. Në të ardhurat maksimale mujore të familjes nuk përfshihen të ardhurat e përfituara nga ndihma ekonomike.

8. Familjet që plotësojnë kriteret sipas pikës 5, të këtij vendimi, paraqesin pranë njësive të qeverisjes vendore kërkesën për përfitimin e grantit të menjëhershëm, në çastin e paraqitjes së dokumentacionit sipas vendimit nr. 574, datë 29.8.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”.

9. Ngarkohen organet e qeverisjes vendore dhe ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 528, datë 6.8.2014

PËR TAVANET PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2015-2017

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, dhe të nenit 23, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2015-2017, sipas lidhjes nr. 1, “Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 110, datë 27.2.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2015-2017”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësiti e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tavanet e Ministrive dhe Institucioneve Buxhetore, në milion Lekë

viti 2015										viti 2016										viti 2017									
600-601				602-606				230-231		Transferim për Fondet Speciale ISSH +ISKSH+KP				600-601				602-606				230-231		Transferim për Fondet Speciale ISSH +ISKSH+KP					
Paga+Sig.sh oq.				Te tjera Korente				Investime/ brendshme / huaja		Totali				Paga+Sig.sh oq.				Te tjera Korente				Investime/ brendshme / huaja		Totali					
Emërtimi i Institutit Buxhetor																													
1	Presidencia	100	72					5		177					181					76		5				181			
2	Kuvendi	600	381	49				49		1.030	600	400	400	400	1.049	600	400	400	400	400	49					1.049			
3	Kryeministria	225	234	60				60		519	225	246	246	246	531	225	246	246	246	60					531				
4	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes	435	305	182	1.000			1.000		1.922	435	286	182	1.000	1.903	435	286	182	1.000	1.903	132	1.000				1.853			
5	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujave	1.753	3.180	925	2.000			2.000		7.859	1.753	3.350	925	2.000	8.029	1.753	3.350	925	2.000	8.029	425	2.000				7.529			
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturas	435	2.257	10.818	29.025					42.535	435	2.260	9.471	23.450	35.616	435	2.260	9.471	23.450	35.616	435	2.260	22.550			30.931			
7	Ministria e Financave	3.291	2.057	467	700					6.515	3.291	2.160	467	700	6.617	3.291	2.160	467	700	6.617	367	700				6.517			
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	29.711	7.234	2.330	2.000					41.274	30.911	8.195	3.830	2.000	44.936	31.211	9.587	3.830	2.000	44.936	5.478	2.000				48.275			
12	Ministria e Kulturës	884	369	164						1.416	884	377	164		1.424	884	377	164		1.424	164					1.425			
13	Ministria e Shëndetësisë	2.634	1.704	790	1.100					26.136	3.182	2.784	790	1.100	34.834	3.379	2.878	790	1.100	34.834	1.890	1.400				36.967			
14	Ministria e Drejtësisë	3.555	1.119	919	300					6.293	3.555	1.070	919	300	6.244	3.555	1.070	919	300	6.244	519	300				5.844			
15	Ministria e Punëve të Jashtme	838	1.413	18						2.269	878	1.320	18		2.216	878	1.320	18		2.216	18					2.216			
16	Ministria e Brendshme	13.314	3.729	800	400					18.243	13.314	3.705	800	400	18.219	13.314	3.705	800	400	18.219	320	400				17.739			
17	Ministria e Mbrojtjes	6.067	4.887	1.500						12.454	6.067	4.526	1.500		12.093	6.067	4.078	1.500		12.093	1.000					11.145			
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	1.004	382	50						1.436	1.004	401	50		1.455	1.004	401	50		1.455	0					1.455			
19	Drejtoria e Radio Televizionit	0	357	0						357	0	375	0		375	0	375	0		375	0					375			
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	134	28	5						167	134	29	5		168	134	29	5		168	29	5				168			
22	Akademia e Shkencës	32	56	2						90	32	58	2		92	32	58	2		92	58	2				92			
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	239	82	20						341	239	85	20		344	239	85	20		344	20					344			
25	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	1.151	24.336	249	500					50.501	76.737	1.151	24.387	249	500	50.992	77.279	1.151	25.975	199	500					80.189			
26	Ministria e Mjedisit	921	236	343	500					2.001	921	248	350	500	2.019	921	248	350	500	2.019	220	500				1.889			
28	Prokuroria e Përgjithshme	1.120	295	135						1.550	1.120	309	135		1.564	1.120	309	135		1.564	135					1.564			
29	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	1.594	336	140						2.070	1.594	335	140		2.068	1.594	335	140		2.068	140					2.068			
30	Gjykata Kushtetuese	81	26	4						111	80	28	4		112	80	28	4		112	28	4				112			
31	Agenzia Telegrafike Shqiptare	77	15	1						93	77	16	1		94	77	16	1		94	16	1				94			
33	Partitë Politike	0	200	0						200	0	200	0		200	0	200	0		200	0					200			
50	Instituti Statistikës	365	104	7						475	365	123	7		495	365	123	7		495	123	7				495			
55	Shkolla e Magistraturës	29	30	1						60	29	31	1		61	29	31	1		61	29	31	1			61			
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	0	1.270	4.500					5.770	0	0	1.250	4.500	5.750	0	0	1.000	4.500	5.750	0	1.000				5.500			
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9	103	2						114	9	98	2		109	9	98	2		109	2					109			
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	64	27	2						93	64	28	2		94	64	28	2		94	28	2				94			
66	Avokatit i Popullit	76	16	4						96	76	17	4		96	76	17	4		96	17	4				96			
67	Komisioni i Shërbimit Civil	33	11	2						45	33	12	2		46	33	12	2		46	12	2				46			
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	68	617	3						688	68	20	3		91	68	635	3		91	635	3				706			
76	Inspektoriati i Lartë Kontrollit të Deklarimit të Pasurive	74	26	4						104	74	27	4		105	74	27	4		105	27	4				105			
77	Autoriteti i Konkurrencës	52	10	1						63	52	11	1		64	52	11	1		64	11	1				64			
78	Ministria e Integrimit Evropian	109	49	38	250					446	101	52	38	250	440	101	52	38	250	440	38	250				440			
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	8	4	1						13	8	4	1		13	8	4	1		13	4	1				13			
87	Institucione të Jera Qeveritare	281	592	331						1.204	281	621	320		1.223	281	621	320		1.223	200					1.103			
88	Agenzia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile	14	106	1						121	14	111	1		126	14	111	1		126	1					126			
89	Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	33	15	1						49	33	13	1		47	33	13	1		47	13	1				47			
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	27	10	1						38	27	11	1		38	27	11	1		38	11	1				38			
92	Instituti i Studimit të Krimeve të Komunitetit	18	13	1						32	18	13	1		32	18	13	1		32	13	1				32			
93	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	431	367	150						948	431	385	150		966	431	385	150		966	100					916			
94	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	621	775	492						1.888	570	666	500		1.736	570	666	500		1.736	202					1.438			

VENDIM
Nr. 529, datë 6.8.2014

PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME EKSPTERTË TË POLICISË SË SHTETIT, NË MISIONIN PAQERUAJTËS TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË SUDANIN E JUGUT (UNMISS)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 10 438, datë 28.6.2011, "Për pjesëmarrjen e Policisë së Shtetit, në misionin policore paqeruajtës dhe humanitare jashtë vendit", të nenit 47, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, "Për Policinë e Shtetit", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e dy ekspertëve të Policisë së Shtetit në misionin paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS).

2. Misioni dhe detyrat e ekspertëve të Policisë së Shtetit do të jenë këshillimi dhe trajnimi i punonjësve të Policisë Kombëtare në Sudanin e Jugut, në mënyrë që të

zhvillohet një forcë policore kombëtare e pavarur dhe profesionale, në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare të OKB-së.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është për një periudhë fillestare 1 (një) vit, me mundësi zgjatjeje të këtij afati.

4. Efektet financiare për periudhën njëvjeçare, gjatë kryerjes së shërbimit, për shpenzimet e transportit vajtje-ardhje për në vendin e dislokimit, akomodimin, sigurimin shëndetësor dhe shpenzimet e jetës përballohen nga OKB-ja, bazuar edhe në udhërrëfyesin e Kombeve të Bashkuara për oficerët e policisë të emëruar në operacionet paqeruajtës dhe në rregulloret e tjera përkatëse të Kombeve të Bashkuara.

5. Policia e Shtetit merr përsipër sigurimin e uniformës, pajisjeve dhe materialeve sipas listës së rekomanduar nga OKB-ja.

6. Efektet financiare për shpenzimet e parashikuara në pikën 5, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi dhe përballohen nga Policia e Shtetit.

7. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

000/lekë

Llogaritja e shpenzimeve

Për personelin e policisë me mision në OKB (UNMISS), Sudani i Jugut-Juba

Nr.	Zërat e shpenzimeve	UNMISS, Sudani i Jugut-Juba		
		Numri i forcave	Kosto për një p/policie për fazë në 000/lekë	Kostoja totale për të gjithë kontingjentin në 000/lekë
1.	Sigurimi i uniformës, pajisjeve dhe materialeve shëndetësore, sipas kërkesave të OKB-së.	2	295	590
	TOTALI I SHPENZIMEVE			590

VENDIM
Nr. 532, datë 6.8.2014

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 116, DATË 5.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR STATUSIN E NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE AKTUALË QË PËRFITOJNË STATUSIN E NËPUNËSIT CIVIL SIPAS LIGJIT NR. 152/2013, "PËR NËPUNËSIN CIVIL""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 67, pika 8, e 69, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013, "Për nëpunësin civil", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"", bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 6, të kreut III, shtohen pikat 6/1 dhe 6/2, me përmbajtje, si më poshtë vijon:

"6/1. Punonjësit e institucioneve të varësisë, pjesë e administratës shtetërore, të cilët bëhen pjesë e shërbimit civil, si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", dhe që në momentin e deklarimit të statusit nuk plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, të pozicionit të punës ku janë të emëruar, të vazhdojnë të punojnë në pozicionet ku janë të emëruar, me kushtin që, brenda një afati 2-vjeçar, t'i plotësojnë këto kushte.

6/2. Për punonjësit, të cilët nuk i plotësojnë kushtet, sipas pikës 6/1, të kreut III, të këtij vendimi, në përfundim të afatit të mësipërm, Departamenti i Administratës Publike njofton njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës, i cili vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës.”.

2. Pas pikës 5, të kreut IV, të shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Afati 2-vjeçar, i përmendur në pikën 6/1, të kreut III, të këtij vendimi, fillon nga data 1 shtator 2014.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 533, datë 6.8.2014

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 514, DATË 30.7.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E VLERËS SË PRONËS PËR SECILIN QARK TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 3, të vendimit nr. 658, datë 26.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 2, të vendimit nr. 514, datë 30.7.2014, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Për kërkesat për shpronësim, të paraqitura në ministrinë kompetente, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të zbatohet vendimi nr. 187, datë 6.3.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 534, datë 6.8.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË. 30.7.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR MINISTRINË E KULTURËS DHE QENDRËN KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE QË DO TË KRYHEN NË KUADËR TË ORGANIZIMIT TË PUNËVE NË VIJIM TË ARDHJES SË PAPA FRANÇESKUT NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3, e vendimit nr. 515, datë 30.7.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Këto fonde të përballohen nga fondi i kontingjencës për vitin 2014.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 535, datë 6.8.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 414, DATË. 25.6.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR MINISTRINË E FINANCËVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 414, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Ky fond të përballohet nga fondi i kontingjencës për vitin 2014.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 537, datë 6.8.2014****VENDOSI:**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË
VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE
CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT
DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË
KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË
LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT,
KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E
PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË
PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË
KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI
TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE
ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", dhe të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1, emërtesa "Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit", zëvendësohet me "Autoriteti i Mediave Audiovizive".

b) Në fund të pikës 1/2, shtohet emërtesa "Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit".

c) Në lidhjen nr. 3, që përmendet në pikën 3, bëhen këto ndryshime:

i) Emërtesa "Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit", zëvendësohet me "Autoriteti i Mediave Audiovizive".

ii) Në ndarjen "Autoriteti i Mediave Audiovizive" shtohen emërtesat, si vijon:

"- Kryetar i Këshillit të Ankesave – II-b;"

- Anëtar i Këshillit të Ankesave – III-a".

ç) Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

"9/1. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar i institucionit" në Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, janë sipas lidhjes nr. 5/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij."

d) Lidhja nr. 9, që përmendet në pikën 13, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2014, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2014.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe, për Sekretariatit e Këshillit Kombëtar të Ujit, i shtrin efektet financiare nga momenti i emërimit të nëpunësve.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

Lidhja nr. 5/4

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" në Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Titullar i institucionit	I-b	1
Drejtor Drejtorie	II-b	1
Përgjegjës Sektori	III-a/1	1
Specialist	III-b	1 ose 2

Lidhja nr. 9

Kategoritë e pagave të nëpunësve në institucionet rajonale/vendore, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, ministrave të linjës, të institucioneve rajonale/vendore në varësi të institucioneve të përcaktuara në pikën 1, të institucioneve vendore në varësi të institucioneve rajonale, të punonjësve që kryejnë funksione të deleguara të pushtetit qendror në pushtetin vendor, të Bordeve të Kullimit, të Komisioneve Vendore të Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore, pranë Prefektit të Qarkut

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Titullar i institucionit rajonal Kryetar i Zyrës së Përmbarimit Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Përgjegjës i degëve të thesarit në qendër qarku Përgjegjës Seksioni në Seksionet e Administrimit dhe të Mbrojtjes së Tokës në Qarqe Kryeinspektor në Inspektoratet e Mbrojtjes së Tokës në Qarqe	III-b	1
Titullar i institucionit vendor Përgjegjës i zyrës rajonale Përgjegjës Sektori në institucionet rajonale Përgjegjës Sektori në Drejtoritë e Bujqësisë Përgjegjës Sektori në Degën e Thesarit Tiranë Përgjegjës të degëve vendore të thesarit Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar) Përgjegjës i gjendjes civile pranë prefektit	IV-a	1
Përmbarues Gjyqësor në Zyrat e Përmbarimit Gjyqësor Specialist në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Specialist në degët rajonale të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit Inspektor të sistemit të Ministrisë së Bujqësisë	IV-a	1 ose 2 ose 3
Përgjegjës Sektori i institucionit vendor Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në komuna (si funksion i deleguar)	IV-b	1
Specialist i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar) Specialist në Drejtoritë e Bujqësisë Specialist i gjendjes civile pranë prefektit Specialist në institucionet rajonale Restaurator arti Arkitekt Inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës në Qarqe Specialist në degët e thesarit Inspektor pune Inspektor në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor në nivel rajonal Inspektor në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Specialist në zyrën vendore të Shërbimit të Provës	IV-b	1 ose 2 ose 3
Specialist në institucionet vendore Specialist i zyrës së gjendjes civile në komuna (si funksion i deleguar) Restaurator Instruktor Piktor Kontrollor pune Specialist në zyrën vendore të Shërbimit të Provës	IV-c	1 ose 2 ose 3

VENDIM**Nr. 538, datë 6.8.2014**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT
2014, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS PËR
AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR DHE
MINISTRINË E KULTURËS, PËR MBULIMIN E
SHPENZIMEVE QË DO TË KRYHEN NË
KUADËR TË ORGANIZIMIT TË PUNËVE NË
VIJIM TË ARDHJES SË PAPA FRANÇESKUT NË
SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, t’i shtohet fondi prej 22 709 962 (njëzet e dy milionë e shtatëqind e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekësh, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për mbulimin e shpenzimeve që do të kryhen për rikonstruksionin e rrugës pranë shoqatës “Petania”, në Bubq, në kuadër të organizimit të punëve në vijim të ardhjes në Shqipëri të Papa Françeskut.

2. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, t’i shtohet fondi prej 39 530 820 (tridhjetë e nëntë milionë e pesëqind e tridhjetë mijë e tetëqind e njëzet) lekësh, me qëllim mbulimin financiar të realizimit të dekorit, brandimit dhe aspekteve organizative për realizimin e ceremonialit të vizitës së Papa Françeskut në Tiranë, më 21 shtator 2014.

3. Ky fond të përballohet nga fondi i kontingjencës për vitin 2014.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Kulturës, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Sekretariati Teknik i Komisionit Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 541, datë 7.8.2014**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT
2014, MIRATUAR PËR DISA INSTITUCIONE,
PËR FESTIMET E 70-VJETORIT TË ÇLIRIMIT
TË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 10 066 000 (dhjetë milionë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh, për prodhimin e medaljeve përkujtimore dhe organizimin e ceremonisë ushtarake për 70-Vjetorin e Çlirimit.

2. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, për organizimin e koncertit me rastin e përvjetorit të Konferencës së Pezës.

3. Ministrisë së Punëve të Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin “Policia e Shtetit”, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për organizimin e përgjegjësisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme në realizimin e ceremonisë ushtarake me rastin e 70 - Vjetorit të Çlirimit.

4. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin “Arti dhe kultura”, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 5 300 000 (pesë milionë e treqind mijë) lekësh, për organizimin e ekspozitës “Shqipëria 70 vjet imazhe, 1944 – 2014”.

5. Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Arkivit Qendror të Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 2 100 000 (dy milionë e njëqind mijë) lekësh, për realizimin e albumit fotografik me fotografi nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare.

6. Efektet financiare prej 23 466 000 (njëzet e tre milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2014.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e

Kulturës, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 2, datë 6.8.2014

**PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË
NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI
KOMBËTAR I BANESAVE, PËR VITIN 2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh”, të nenit 34/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Kostoja mesatare e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë republike, për vitin 2014, të jetë 39 482 (tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) lekë/m², për sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2014, të jetë sipas tabelave nr. 1, nr. 2 e nr. 3, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

3. Për qytetet për të cilat nuk janë nxjerrë vlerat e koston mesatare të ndërtimit të merren vlerat e koston së ndërtimit të qytetit më të afërt, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Vlerat mesatare të banesave në tregun e lirë nuk mund të përdoren për t’iu referuar zonave të afërta.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr. 1

Kostoja mesatare e ndërtimit

Në koston mesatare nuk janë përfshirë vlerat e:

1. Rrjetit inxhinierik
2. Projektit
3. Studimit gjeologjik dhe sizmik
4. Lejës së ndërtimit
5. Truallit
6. Shpenzime operacionale të EKB 4%

Nr.	Qyteti	Kostoja mesatare (aritmetike)	
		Sip. e shfrytëzimi lekë / m ²	Sip. e ndërtimi lekë / m ²
1	Elbasan	39,267	32,421
2	Gramsh	39,267	32,421
3	Librazhd	39,477	32,595
4	Përrenjas	39,477	32,595
5	Peqin	39,267	32,421
6	Pogradec	39,432	32,544
7	Korçë	39,432	32,544
8	Ersekë	39,601	32,686
9	Tiranë	38,708	31,958
10	Durrës	38,407	31,709
11	Kavajë	38,407	31,709
12	Lushnjë	36,657	30,246
13	Fier	37,624	31,057
14	Vlorë	39,743	32,817
15	Berat	39,401	32,531
16	Kuçovë	39,401	32,531
17	Skrapar	39,401	32,531
18	Përmet	39,766	32,826
19	Tepelenë	39,766	32,826
20	Gjirokastër	39,766	32,826
21	Sarandë	40,281	33,252
22	Krujë	39,791	32,851
23	Laç	39,657	32,740
24	Lezhë	39,657	32,740
25	Rrëshen	39,895	32,936
26	Shkodër	39,803	32,861
27	Pukë	40,542	33,467
28	Kukës	40,665	33,567
29	Tropojë	40,665	33,567
30	Mat	40,354	33,312
31	Peshkopi	40,354	33,312
Kostoja mesatare		39,482	32,594

Tabela nr. 2

Vlerat mesatare të shit-blerjeve të banesave në tregun e lirë për vitin 2014 sipas qyteteve

Nr.	Qyteti	lekë/m ² sipërfaqe shfrytëzimi
1. Qarku Tiranë		
1	Tiranë	89,125
2	Vorë	51,500
3	Kamëz	51,700
4	Kavajë	58,430
5	Rrogozhinë	41,000
2. Qarku Durrës		
6	Durrës	70,093
7	Krujë	48,500
8	Shijak	42,730
9	Sukth	41,500
10	Fushë-Krujë	51,000
3. Qarku Shkodër		
11	Shkodër	57,500
12	Pukë	22,000
13	Vau Dejës	24,300
14	Koplik	40,500
15	Fushë - Arrëz	7,500
4. Qarku Vlorë		
16	Vlorë	61,655
17	Orikum	62,000
18	Selenicë	25,500
19	Himarë	54,000
20	Sarandë	50,780
21	Delvinë	26,750
22	Konispol	28,000
5. Qarku Korçë		
23	Korçë	47,000
24	Pogradec	50,000
25	Bilisht	35,000
26	Ersekë	23,200
27	Maliq	27,800
28	Leskovik	21,000
6. Qarku Fier		
29	Fier	53,200
30	Lushnjë	38,500
31	Ballsh	30,100
32	Patos	28,000
33	Divjakë	45,000
34	Roskovec	30,000
7. Qarku Berat		
35	Berat	42,190
36	Kuçovë	40,300
37	Poliçan	25,500
38	Çorovodë	22,800
39	Ura-Vajgurore	37,300
8. Qarku Elbasan		
40	Elbasan	50,400
41	Librazhd	44,020
42	Cërrik	38,300
43	Gramsh	43,023
44	Peqin	39,070
45	Përrenjas	41,780
46	Belsh	35,000
9. Qarku Gjirokastrë		
47	Gjirokastrë	49,580
48	Përmet	32,600
49	Tepelenë	28,400

50	Memaliaj	13,900
51	Këlcyrë	24,600
52	Libohovë	28,400
10. Qarku Lezhë		
53	Lezhë	56,000
54	Laç	42,500
55	Mamurras	31,000
56	Rrëshen	42,000
57	Rubik	29,500
11. Qarku Kukës		
58	Kukës	53,700
59	Bajram-Curri	27,190
60	Krumë	24,500
12. Qarku Dibër		
61	Peshkopi	48,620
62	Burrel	44,180
63	Bulqizë	42,980
64	Klos	32,000
Komunat		
65	Komuna Shëngjin	61,500
66	Komuna Milot	34,200
67	Komuna Kërrabë	28,200
68	Komuna Kashar	52,500
69	Komuna Dajt	53,000
70	Komuna Farkë	64,500

Tabela nr. 3

Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës për vitin 2014

Nr.	Zonat	Lekë/m ² sipërfaqe shfrytëzimi
1	1/1	98,000
2	1/2	80,000
3	2/1	187,000
4	2/2	135,000
5	2/3	95,000
6	2/4	110,000
7	2/5	80,000
8	3/1	75,000
9	3/2	60,000
10	4/1	70,000
11	4/2	60,000
12	5/1	190,000
13	5/2	131,700
14	5/3	107,000
15	5/4	80,000
16	6	65,000
17	7/1	120,000
18	7/2	100,000
19	7/3	85,000
20	7/4	65,000
21	8/1	110,000
22	8/2	100,000
23	8/3	72,000
24	9/1	130,000
25	9/2	100,000
26	9/3	75,000
27	10/1	145,000
28	10/2	140,000
29	10/3	100,000
30	11/1	87,000
31	11/2	75,000
32	11/3	70,000

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 36 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006